



Gripi i shpendëve:
Ministria e Bujqësisë
merr masa dhe
monitoron
tregun

Faqe 4



**Ditët e Edukimit
Financiar dhe
Dixhital të organizuar
në degët e FED invest
nga data
17 mars - 25 prill**

Faqe 6



**Rama, Bord
transparence për
çmimet e shportës,
kush abuzon i
konfiskohet malli**

Faqe 7



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KESHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit mars 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 434
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

3.7 MILIARDË LEKË PËR SUBVENCIONIMIN E 13 MASAVE MBËSHTETËSE

MASAT E MBËSHTETJES NË BUJQËSI, NGA PAGESAT DIREKTE 200,000 LEKË/HA PËR SERRAT, NAFTA FALAS DHE SUBVENCIONET PËR HERË TË PARË NË PESHKIM

Thirrja e hapur për mbështetje në Bujqësi, deri më 30 mars

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Certifikimi i fruta-perimeve çelsi për të diversifikuar tregjet e eksportit



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2

HISTORI SUKSESI

Elma Bejo, modeli që frymëzon brezat e rinj



Faqe 5

SKEMA KOMBËTARE E MBËSHTETJES PËR FERMERËT 2022

APLIKO 25 SHKURT - 30 MARS

azhbr agro pika dokumenta e-Albania Agropika

azhbr.gov.al 08008383

BUJQËSIA BIOLOGJIKE

Mendime për zhvillimin e përsheptuar të bujqësisë dhe të fshatit

Përgatiti Prof. Ass. Enver ISUFI
Instituti i Bujqësisë Biologjike, Durrës

Faqe 10

KËNDI I EKSPERTIT

- Teknika e rritjes dhe e mbarështimit të zogjve Brojler, dhe përdorimi i racionit ushqimor me ushqime të peletuara Fq.11
- Problematikat e kultivimit të misrit në Shqipëri Zgjedhja e hibrideve të misrit për mbjelljet e pranverës 2022 Fq.12
- Kalendari bujqësor, muaji prill 2022 Fq.13

Krifca: Sjellja konsumatore e stabilizuar, zinxhir tregtar shumë më normal

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca ka takuar importuesit e grurit në bordin e radhës së monitorimit të çmimeve, për të dakorduar mbi çmimin e miellit deri më datën 10 Prill.



Faqe 4

BASHKIMI EVROPIAN

KE, 112 milionë euro për fermerët



Faqe 5

RISI ALBANIA

Certifikimi i fruta-perimeve çelsi për të diversifikuar tregjet e eksportit

Shumë rrjete të mëdha të supermarketeve apo aktorë të tjerë në industrinë e ushqimit në tregjet me vlerë të lartë po kërkojnë gjithnjë e më tepër standarte që lidhen kryesisht me sigurinë ushqimore, standarte sociale dhe të mjedisit.

Një shembull konkret ku doja të ndalesha është rrjeti i supermarketit Lidl me qendër në Gjermani të cilet kanë filluar të kenë sëfundit një shtrirje dhe në vëndet fqinje si Serbia dhe Maqedonia.

Gjatë 2021 kompania ka pasur target që 100% e fruta perimeve të jenë të certifikuar me GlobalG.A.P.

Disa prej standarteve që Lidl kërkojnë nga furnitoret e tyre janë:



GlobalG.A.P GRASP



Rainforest Alliance



Fairtrade Standard për fruta perime



Sedex Members Ethical Trade Audit



Më shumë certifikime...

Sipas tendencave që po përforcohen gjithnjë e më tepër kompanitë Europiane po shtojnë kërkesat e tyre për standarte që lidhen me qëndrueshmërinë për të siguruar që ushqimet e importuara në Europë janë prodhuar në një mënyrë të qëndrueshme. Standarte të ndryshme të cilat janë vullnetare dhe promovohen nga importues, tregtarë dhe rrjete të shitjes me pakice. Për vendet si Shqipëria ku eksperiencia në keto standarte është e vogël gjithnjë e më tepër bëhet e veshitë procesi i furnizimit duke plotësuar këto kërkesa. Këshillohet nga ekspertet që eksportuesit dhe prodhuesit të fokusohen në implementimin dhe certifikimin e standarteve që kërkojnë nga klienti.

Çfarë mësim mund të nxjerrim nga Certifikimi në Grup GlobalG.A.P.?

Certifikimi GlobalG.A.P është një certifikim për prodhuesin. Implementimi i tij tek fermerë individual është jo i lehtë kjo duke pasur parasysh që rreth 80% e fermerëve kanë më pak se 2 HA tokë. Në 2018 në shume takime që kam pasur me eksportues konkluzioni ishte që certifikimi shikohej pothuajse i pamundur. Kjo pasi me një llogari të thjeshtë nëse një fermer individual duhet të paguante total nga 2000-3000 Euro për asistencën në implementim dhe kostot e certifikimit për fermerin e tij individuale. Eksportuesit furnizohen nga shumë fermerë (nga 500 deri në 2000 fermerë). Nëse do të certifikoheshin 50 fermerë në mënyrë individuale (opsioni 1) atëherë kosto e certifikimit do të shkonte rreth 100,000 Euro. Kjo shifer është jo e vogël për tu paguar nga eksportuesit apo fermerët.

Ndërkohë mungonte informacioni dhe ekspertiza për opsionin 2, certifikimi në grup

I fermerëve. Rreth 73% e të gjithë fermave në bote janë të certifikuar në grup (burimi GlobalG.A.P). Certifikimi në Grup është një opsion që ju jep mundësinë dhe fermerëve të vegjël të certifikohen. Ky opsion ju jep mundësinë fermerëve të certifikohen në grup me 50, 100, 500 apo më shumë fermerë. Si grup marrin një certifikatë të vetme në emër të aplikuesit kryesor dhe fermerët e tjerë identifikohen me një numër specifik. Por, në Shqipëri fermerët nuk janë lidhur direkt me tregun e eksportit, treg I cili ka më shumë interes për produkt të certifikuar. Gjithashtu fermerët nuk janë të organizuar në kooperativa dhe kjo e bën të vështirë që vetë fermerët të bëjnë të mundur të implementonin dhe të menaxhonin një certifikimin në grup.

Cili është roli që luan eksportuesi në certifikimin në grup kur dimë që GlobalG.A.P është për prodhuesin?

Eksportuesit kanë bashkëpunim me fermerët në disa drejtime si psh; menaxhimi grupin e fermerëve në prodhim duke i këshilluar, orientojnë fermerët për kultivimet që ata do të bëjnë etj. Eksportuesit

Global G.A.P është një standart i sigurisë ushqimore i bazuar në implementimin e praktikave të mira bujqësore përgjatë zinxhirit agro – ushqimor, që nga prodhimi në nivel ferme, vjelja e produkteve, paketimi, ruajtja dhe transporti. Standarti përcakton praktikën që duhet të ndjekin prodhuesit dhe eksportuesit e fruta perimeve, që të shmangin kontaminim e produkteve ushqimore, të reduktojnë përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve (pesticideve), të minimizojnë impaktin negativ të bujqësisë në mjedis, të përdorin me efikasitetet burimet natyrore dhe të kujdesen për shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve.

GLOBALG.A.P. Vlerësimi i rrezikut në praktikën sociale (GRASP) është një modul vullnetar i zhvilluar për të vlerësuar praktikën sociale në fermë, duke trajtuar aspekte të veçanta të shëndetit, sigurisë së punëtorëve dhe mirëqenien. GRASP ndihmon prodhuesit të krijojnë një sistem të mirë të menaxhimit social në fermat e tyre. Ajo u ofron blerësve siguri të shtuar dhe ndihmon në mbrojtjen e një prej burimeve më të rëndësishme të fermës: të saj njerëzit. Masat e GRASP vlerësohen së bashku me GLOBALG.A.P. auditimit.

Prodhuesit që marrin pjesë në skemë duhet të respektojnë kërkesat e standartit që mbulojnë çështje si: siguria e ushqimit, kualiteti i produktit, gjurmueshmëria, mbrojtjen e mjedisit, mirëqenia e stafit, biodiversiteti, efikasiteti i burimeve, qëndrueshmëria sociale.

Standarti i Bujqësisë së Qëndrueshme të Aleancës Rainforest përfshin aspektet sociale, ekonomike dhe qëndrueshmëria mjedisore. Standarti identifikon parimet e rëndësishme të qëndrueshmërisë së bujqësisë duke përfshirë ruajtjen e biodiversitetit; përmirësimi i jetesës dhe mirëqenies njerëzore; natyrore ruajtja e burimeve; dhe sisteme efektive të planifikimit dhe menaxhimit të fermës. Fermat e certifikuar Rainforest auditohen rregullisht për të verifikuar nëse fermerët janë në përputhje me standardet kërkesa gjithëpërfshirëse, të cilat kërkojnë përmirësim të vazhdueshëm.

Standarti Fairtrade siguron kushte më të drejta të tregtisë midis fermerëve dhe blerësve, mbron të drejtat e punonjësve dhe përcakton kornizën e duhur që prodhuesit të ndërtojnë ferma dhe organizata fermeresh të qëndrueshme. Parimet bazë të këtij standarti janë zhvillimi social i fermerëve të vegjël dhe grupeve të prodhuesve përmes aksesit në treg dhe pjesëmarrjes demokratike në vendimmarrje, zhvillimi ekonomik përmes vendosjes së cmimeve të drejta midis blerësve dhe prodhuesve si dhe pagesa e cmimeve premium dhe pagesa e parafinancimeve, kujdesi për mjedisin dhe ndalimi i punës së detyruar dhe punës së fëmijëve.

SMETA është një format auditimi i cili është një përmbledhje e praktikave të mira në teknikat e auditimit etik projektuar për të ndihmuar auditorët të kryejnë auditime me cilësi të lartë që përfshijnë të gjitha aspektet e përgjegjësisë praktike e biznesit e krijuar nga Forumi i Palëve të Interesit Sedex.

janë aktorët më të interesuar për të pasur produkte të certifikuar me qëllim hyrjen në tregje me vlerë të lartë dhe për të pasur marzhe më të mira fitimi. Në këto kushte ata kanë interesin dhe mundësinë që ti grupojnë fermerët duke i asistuar në grup që të marrin sëbashku me fermerët certifikimin GlobalG.A.P. Në këtë rast certifikata del në opsionin 2(certifikim në grup) në emër të eksportuesit (si aplikant kryesor dhe që menaxhon grupin e fermerëve). Kosto e certifikimit në grup është shume herë më lirë se certifikimi individual (opsioni 1) I fermerëve. Një shembull tek një eksportues në Shqipëri ka pasur një kosto të certifikimit rreth 10,000 Euro për certifikimin e rreth 60 fermerëve. Nëse do të realizonte certifikimin secili fermer më vehte kosto do të kishte kaluar mbi 50,000 Euro.

Një mesim tjetër nga implementimi i modelit të certifikimit në grup është se eksportuesit ndërtojnë një sistem për mirë menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, kontrollin, inspektimit në kohë të prodhimeve që ata do të tregtojnë. Në rastin e certifikimit GlobalG.A.P në Grup është e detyrueshme ngritja e një sistemi të menax-

himin të cilësisë(QMS-Quality Management System). Qendra e menaxhimit të cilësisë duhet të ketë 3 persona të cilët duhet të jenë specialistë, të kenë eksperiencë dhe kualifikimet përkatëse në fushën agronomike sipas rregullave të GlobalG.A.P. Detyra e ekipit prej 3 personave është të keshillojë, asistojë në implementimin e standartit, inspektojnë dhe auditojë respektimin e rregullave dhe standartit GlobalG.A.P. Pra, ky ekip luan rolin e "trupës certifikuese" brenda këtij grupi.

Për shumë eksportues që implementuan këtë standard nuk ishte e lehtë. Disa prej tyre u asistuan nga konsulentë të jashtëm të cilët në bashkëpunim me agronomët e eksportuesve ngritën këtë sistem punë sipas kriterëve të GlobalG.A.P. Shumë prej eksportuesve u detyruan të punësojnë agronomë e specialistë të fushës pasi ishte kriter nga GlobalG.A.P. Por, kjo praktikë ka filluar të japë rezultat shumë të mirë në mirë menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Kjo praktikë ul risqet që fermerët të ndjekin praktika jo të mira në trajtimin e prodhimit dhe ul dëmet që mund të shkaktohen nga kthimet apo konstatimet në pikat doganore në Europë

të produkteve të eksportuara. Në shumë raste eksportuesit penalizohen me gjoba dhe humbasin klientët të mirë për shkak të mos menaxhimit të prodhimit.

Shtrirja e GlobalG.A.P në Shqipëri ka pasur efekt pozitiv në rritjen e eksporteve drejt tregjeve me vlerë të lartë në 2-3 vitet e fundit. Ku shembull janë perimet të cilat në vlerë të eksportuar drejt 5 vendeve të ballkanit kanë pasur rritje vetëm 3% por kanë pasur rritje drejt tregjeve me vlerë të lartë me rreth 56%.

Modeli i Certifikimit në grup GlobalG.A.P është një zhvillim shumë pozitiv i cili na shërben si model suksesi dhe për të zhvilluar më shumë prodhimin dhe tregëtimin e fruta perimeve organike ku Shqipëria ka një potencial jo të vogël. Në sajë të qëndrës së menaxhimit të cilësisë mund të bëhet e mundur pilotimi i certifikimit organik nga Eksportuesit.

Hapat që mund të ndërmerren eksportuesit për të filluar certifikimin në grup me fermerët.

Një përshkrimi i thjeshtëzuar i hapave të cilat duhet të ndjekin eksportuesit janë:

- Si fillim eksportuesit nëse nuk kanë konsulent për GlobalG.A.P brenda kompanisë duhet të kontraktojnë një konsulent apo kompani konsulente e cila ka experience në këshillimin për implementimin e GlobalG.A.P në grup. Këshillimi me konsulentin për ngritjen e ekipit për menaxhimin e sistemit të cilësisë.

- Identifikimi i fermerëve dhe i produkteve të cilat do të jenë pjesë e certifikimit në grup. Më pas ndiqen hapat për identifikimin e trupës certifikuese ku do të bëhet regjistrimi i fermerëve dhe i produkteve.

- Këshillimi dhe asistencën për implementimin e standartit, përfshirë analizat përkatëse që kërkojnë nga standarti, inspektimi, auditimi i fermerëve nga qendra e menaxhimit të cilësisë (me ndihmën e konsulentit të jashtëm).

- Pasi janë implementuar me sukses dhe produkti është gati për vjelje thirret trupa certifikuese e cila bën inspektimin dhe auditimin e qëndrës së menaxhimit të cilësisë dhe vefikimi i implementimit tek fermerët. Nëse ky process del me sukses eksportuesi sëbashku me grupin e fermerëve pajisen me certifikatën GlobalG.A.P.

3.7 MILIARDË LEKË PËR SUBVENCIONIMIN E 13 MASAVE MBËSHTETËSE

MASAT E MBËSHTETJES NË BUJQËSI, NGA PAGESAT DIREKTE 200,000 LEKË/HA PËR SERRAT, NAFTA FALAS DHE SUBVENCIONET PËR HERË TË PARË NË PESHKIM

Thirrja e hapur për mbështetje në Bujqësi, deri më 30 mars

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i bëri apel fermerëve të aplikojnë për të përfutuar nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi, teksa njofton se “afati i aplikimit është shtyrë me 5 ditë, deri në datën 30 mars 2022”.

Skemat e subvencionimit në ndihmë të bujqësisë përfshijnë një game të gjerë sektorësh duke nisur nga mbështetja e prodhimit në serra, peshkimit, vazhdimi i skemës të naftës për rimbursimin e taksave, ndërtimin e tregjeve për kafshët e gjalla dhe digjitalizimin e bujqësisë.

Për fermerët e serrave subvencionet do të jenë në formën e pagesave direkte që nisin nga 200,000 lekë/ha për 2 sezona të mbjellash për kultivimin e perimeve, rrushit të tavolinës dhe luleshtrydheve.

Mbështetja ndaj fermerëve të serrave do të mbulojë shtimin e kostove nga çmimet e larta të imputeve bujqësore në tregjet ndërkombëtare të lidhura me krizën energjetike. Ndërsa nafta falas do të prekë një masë të gjerë të sistemeve të prodhimit.

Vitin e kaluar nisi për herë të parë skema e mbështetjes me naftë falas për fermerët që do të vijojë zbatimin edhe këtë vit, duke përfshirë rimbursimin e akcizës dhe taksës të qarkullimit për fermerët që kryejnë punime të mekanizuara në kulturat bujqësore. Shteti subvencionon 80,4 lekë nga çmimi i naftës, teksa Qeveria shtoi fondin për naftën falas në bujqësi edhe me 500 milionë lekë.

Deri më 23 mars, shënohen mbi 38 mijë aplikime për 9.4 milionë litra naftë, ndërkohë që vijojnë aplikimet deri më 30 mars 2022.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca shpreh: “Përmasë këtyre skemave mbështetjen kulturat e grurit dhe misrit, produktet jetike të cilat janë goditur rëndë sot nga lufta në Ukrainë”.

Sipas saj, të dhënat paraprake tregojnë se rreth 40 % e sipërfaqes së kultivuar me grurë dhe 50 % e sipërfaqes së kultivuar me misër do të mbështeten nga Skema Kombëtare. “Në situatën aktuale këto të dhëna na bëjnë të jemi shpresëplotë se sipërfaqet e kultivuara me misër dhe ato që do të mbillen me grurë do të ruajnë të njëjtat nivele me ato të tre viteve të fundit. Të gjitha këto masa janë marrë me qëllim që të mos dekurajohen fermerët për të ulur sipërfaqet e mbjella si dhe të lehtësojmë kostot e tyre”, deklaroi ajo.

Krifca tha: “Qeveria ka vendosur të ndikojë në absorbimin e kostove në bujqësi në dy drejtime të ndryshme për fermerët. E para është fondi prej 3.2 miliardë lekë nga buxheti i shtetit si

pjesë e skemës në mbështetjen e fermerëve, buxheti i cili u shtua me shumën tjetër prej 500 milionë lekëve masa e mbështetjes për naftë. Kjo skemë e naftës po ecën mjaft mirë, me 40% numër aplikimesh më shumë se vitin e

13 masat e financimeve, arrijnë një total buxheti prej 3.7 miliardë lekësh, duke përfshirë edhe 1.45 miliardë lekë për masën e financimit me naftë për makineritë bujqësore. Në skemë përfshihen sektorët e blegtorisë,

mijë) lekë, në vitin e dytë, 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vitin e tretë 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) për fermë të certifikuar.

d) Implementimi dhe certi-

tuese.

Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të blerjes, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt peshkimi, në rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 11, të nenit 30, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin” të ndryshuar.

c) Për rinovimin infrastrukturës së anijes së peshkimit. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të blerjes, por jo më shumë se 7,250, 000 lekë për anije peshkimi të pajisur me leje të vlefshme peshkimi tregtar dhe jo më shumë se 20,000,000 lekë për subjekt.

Rinovimi i anijes së peshkimit përfshin: i. blerjen dhe instalimin e motorit kryesor, por jo më shumë se 4,000,000 lekë; ii. blerjen dhe instalimin e motorit ndihmës (gjeneratori detar), por jo më shumë se 2 000 000 (dy milionë) lekë; iii. blerjen dhe instalimin e vinçit të anijes, por jo më shumë se 1,250,000 lekë.

Naftë për bujqësinë

Mbështetja me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, në vlerën deri në 950,000,000 lekë. Subjektet përfituese mbështeten me sasi naftë falas në barazvlerë të lehtësimit fiskal të naftës që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kriterëve dhe masës së përfitimit, të përcaktuara në këtë vendim.

Kulturat bujqësore/grup-kulturat, normativat e konsumit të naftës dhe sasia përkatëse e naftës që përfitohet falas janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është me burim informacioni Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Subjektet përfituese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës;

b) madhësia totale e fermës duhet të jetë me sipërfaqe jo më pak se 0.4 ha, ndërsa madhësia e parcelave me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

– Aplikimi për të përfutuar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet online në portalin e-Albania, me vetëdeklarim. Përfitimi i sasisë së naftës falas për sipërfaqen që kultivohet, është, si më poshtë vijon:

a) 100% e sasisë për subjektet me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përlllogaritjeve të bëra referuar aneksit 1, bashkëlid-

hur këtij vendimi;

b) subjektet me sipërfaqe mbi 10 ha, për sipërfaqen deri në 10 ha, përfitojnë sasi të përcaktuara të shkronjës “a” të kësaj pike, ndërsa për pjesën tjetër mbi 10 ha përfitojnë sasinë e naftës me normativë të reduktuar.

Normativa e reduktuar përlllogaritjet bazuar në nevojat për naftë të subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha, por jo më shumë se normativa e lejuar, si dhe në sasinë e mbetur të naftës në dispozicion, pasi janë plotësuar nevojat deri në 10 ha të gjitha subjekteve, që janë kualifikuar si përfitues pjesë përbërëse e tij.

Si çmim referencë për naftën do të merret çmimi i botuar në Buletin e Njoftimeve Publike, i Agjencisë së Prokurimit Publik, nr. 5, datë 7.2.2022 (rubrika “Të dhëna për karburantet”)

Tregje të produkteve bujqësore dhe të kafshëve të gjalla

Mbështetja për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe/ose tregjeve të kafshëve të gjalla për shoqëritë aksionare me kapital 100% shtetëror, në vlerën jo më shumë se 30,000,000 lekë, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferata të brendshme”.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) ekzekuton transferimin e fondit përkatës të bashkia përkatëse, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.

Inovacione dhe digjitalizim në bujqësi

a) Mbështetja për ngritjen e një skeme kombëtare trajnimit në bujqësi dhe ngritjen e Qendrës së Ekselencës dhe Inovacionit të Sistemeve Prodhuese, në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), në bashkëpunim me një nga universitetet evropiane, në vlerën deri në 50,000,000 lekë, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferata të brendshme”. AZHBR-ja ekzekuton transferimin e fondit përkatës tek UBT-ja, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.

b) Mbështetja për automatizimin dhe digjitalizimin e proceseve të punës në fermë. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1,000,000 lekë për subjekt.

SKEMA KOMBËTARE E MBËSHTETJES PËR FERMERËT 2022

APLIKO 25 SHKURT – 30 MARS



kaluar, kjo tregon se politikat e qeverisë janë të duhurat”.

“Nga ana tjetër, vijoi Krifca, ky 3.2 miliardë që tashmë është bërë 3.7 miliardë lekë, ndikon edhe në një masë tjetër të rëndësishme që është masa e imputeve bujqësore, për prodhimet në serrë, të rrushit të tavolinës dhe të luleshtrydhes”.

Sipas saj, këto prodhime kanë ndikim në eksportet bujqësore, ndërsa shtoi se nëse fermerët aplikojnë në dy sezona të ndryshme mund të përfitojnë deri në 400 mijë lekë për inputet, fidanët të certifikuar.

Për herë të këtij vit do të aplikohet edhe skema me subvencione për sektorin e peshkimit. Për rinovimin e anijes të peshkimit do të rimbursohet nga shteti 50% e totalit të investimit por jo më shumë se 20 mln lekë. Për rinovimin infrastrukturës së anijes së peshkimit, masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të blerjes, por jo më shumë se 7,250, 000 lekë.

Për masat nga 1 deri 6 të mbështetjes, aplikimet kryhen online në portalin e-Albania, por edhe në një nga 79 sportelet e bujqësisë që gjenden në të gjithë vendin, apo në pikat ADISA me zero dokumente.

Këtë vit skema kombëtare e bujqësisë synon të realizojë dy qëllime kryesore, uljen e kostos së prodhimit për shkak të rritjes së çmimeve dhe rritjen e eksporteve.

peshkimit, bletarisë, bujqësisë, certifikimi, e të tjera.

Skemat e subvencionimit Serra

a) Mbështetja për fara/fidanë dhe inpute të tjera me 200,000 (dyqind mijë) lekë për ha, për sezon dhe jo për më shumë se 2 sezona, për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermerë individualë ose grup-fermerësh, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për aplikant.

b) Për ndërtimin e serrave diellore të reja për prodhimin e perimeve me sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 5 (pesë) ha për subjekt, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë për ha.

c) Mbështetja për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë/ha, për fermerë individualë ose grup-fermerësh, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha, por jo më shumë se 1,000,000 (një milion) lekë për aplikant.

ç) Fermat organike për përiudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100,000 (njëqind

fikimi global GAP, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore:

i. por jo më shumë se 175,000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha;

ii. por jo më shumë se 500,000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 ha në fushë të hapur.

Blegtoria dhe peshkimi

Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuere), për fermat me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë, por jo më shumë se 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për subjekt, ndërsa për fermat me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt.

a) Mbarështrim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë për zgjuar, për ferma me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë) mijë lekë për subjekt.

b) Për blerjen e anijeve të peshkimit tregtar profesional, që zëvendësojnë anijet ekzis-

Rama: Mbështetja për fermerët për naftën pa taksa 1.45 miliardë lekë

Kryeministri Edi Rama deklaroi se qeveria do të bëjë gjithçka është e mundur për të mbështetur ata që kanë më tepër nevojë për mbështetje, duke përfshirë edhe fermerët, ndërsa foli edhe për hapa të matur për shkak të pasigurisë që ka sjellë agresioni ushtarak i Rusisë në Ukrainë.

Gjatë një takimi me fermerë në Durrës për të prezantuar Paketën e Rezistencës Sociale të miratuar nga qeveria, Rama

Rama bëri të ditur se megjithëse është dyfishuar sipërfaqja e tokës së punuar sërish mbetet shumë për tu bërë dhe se bashkimi i fermerëve është një nga instrumentet që do të çojë në më shumë prodhim vendas jo vetëm në tregjet shqiptare por edhe në ato të huaja.

“E mentalitetin në kuptimin e të qenurit të ndarë, secili për vete. Në bujqësi nuk mund të shkohet larg duke menduar

për atë se çfarë do të mbillet si do të trajtohet dhe të shesin së bashku. Pra të ndarë në prodhim dhe të bashkuar në shitje është sekret i suksesit. Aty ku kemi shumë ndarje ndeshemi me fenomenin e hedhjes së prodhimit, sepse janë sasira të vogla dhe bëhet e pamundur për ti shitur”, tha Rama.

Kryeministri foli me shifra teksta tha se synohet që në fund të mandatit eksportet bujqësore të shkojnë në 1 miliard lekë nga 125 milionë që ishin 7-8 vite më parë.

“Shqipëria sot punon dyfishin e tokës bujqësore që punonte para 7-8 vitesh. Ky fakt tregon se Shqipëria ka bërë hapa para dhe ka një fuqi të madhe të shtuar. Fakti i dytë është se punimi i dyfishit të tokës shikohet te import-eksportet.

Ne eksportojmë 1 dhe importojmë 7 pra raporti ishte 1 me 7 sot raporti është 1 me tre. Kjo sepse ka prodhim më shumë vendas se sa të huaj në tregun tone. Eksportet tona bujqësore kanë shkuar afër gjysmë miliardshit, ndërsa ishin 125 milionë dollarë duke përfshirë edhe peshkimin. Dhe ambicia jonë është të shkojmë në 1 miliard dollarë në fund të këtij mandate”, tha Rama.



tha se mbështetja për fermerët për naftën pa taksa është 500 milionë lekë dukë e çuar në total 1.45 miliardë lekë fondin në këtë skemë.

secili për vete por vetëm duke bashkuar forcat, jo si më parë bashkim me detyrim por një bashkim me vullnet të lirë ku të gjithë bashkë koordinojnë forcat

Konkurrenca gjobit 3 importues të plehrave kimike

Komisioni i Konkurrencës vendosi gjobitjen e 3 ndërmarrjeve: AGRO BLEND, MBM, dhe CACA, që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, nitrat dhe ure.

Sipas deklaratës për shtyp të Autoritetit të Konkurrencës, kompania “AGRO BLEND” u gjobit në shumën 118,978,015 lekë, kompania MBM në shumën 66,088,573 lekë, dhe CACA në shumën 7,087,994 lekë.

Gati një vit më parë, Komisioni i Konkurrencës, hapin

hetim në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inpueteve bujqësore, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës.

“Referuar analizës së provave indirekte në lidhje me sjelljen e ndërmarrjeve nën hetim, të tilla si: rritja e treguesve të përqendrimit, rritja e njëkohshme dhe në mënyrë të menjëhershme e çmimit të shitjes me shumicë duke përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes dhe duke ndarë tregjet, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi

se, sjellja e ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, MBM SHPK dhe CACA SHPK, gjatë periudhës nën hetim vinte në kundërshtim ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, thuhet në deklaratën e Autoritetit të Konkurrencës.

Përtej gjobitjes së tri ndërmarrjeve të sipërcituara, Komisioni i Konkurrencës vendosi gjithashtu edhe vendosjen nën monitorimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, nitrat dhe ure, për një periudhë 1-vjeçare.

Ibrahimaj: Nuk do ndërhyjmë në TVSH e produkteve të shportës

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj deklaroi se Tatimi mbi Vlerën Shtuar (TVSH) për produktet e shportës nuk do të hiqet, pasi nuk do të përkthehet në ulje të

trja e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj dhe ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca dolën në një deklaratë të përbashkët për shtyp për ngritjen

çmimeve të shportës dhe inpueteve bujqësore.

“Ne nuk do ndërhyjmë në TVSH e produkteve të shportës, çdo vend ka sistemin e vet të taksimit. Vitin e kaluar morëm një vendim i cili prek pjesën më të madhe të biznesëve dhe prek 95 mijë biznese e të vogla ku ne rritëm pragun e TVSH mbi 10 mln lekë. 95 mijë biznese e nuk paguajmë asnjë taksë dhe asnjë TVSH.

Janë produkte që tregtohen kryesisht nga këto biznese. Nëse do t'i referohemi miellit, është miell i cili shkon për konsumin e madh që shitet nëpër furrat e bukës, apo pika shumice. Është vetëm një 10% që shitet me kg. Çdo konsumator konsumon më shumë bukë sesa miell për kg”, tha Ibrahimaj.



çmimit për konsumatorin. Mbrëmjen e sotme, ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca

do të përkthehet në ulje të çmimit për konsumatorin. Mbrëmjen e sotme, ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca

Fond garancie tregtarëve që familjet të mos paguajnë më shumë seç duhet

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj deklaroi se qeveria ka vendosur një fond garancie në dispozicion të tregtarëve kryesorë për të blerë produktet bazë ushqimore, në mënyrë që qytetarëve shqiptarë të mos u mungojnë në një periudhë afatmesme.

Kjo u bë e ditur gjatë një deklaratë të përbashkët për shtyp me ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, pas një maratone diskutimesh me përfaqësuesit e shitësve të shumicës dhe pakicës për disa nga ushqimet bazë.

Ibrahimaj tha se takimi i Bordit të Monitorimit dhe Transparencës së Çmimeve për produktet bazë do të vijojë edhe nesër për të ngritur instrumentin me të cilin do monitorohet tregu.

“Qëllimi i këtij bordi është përcaktimi i instrumentit që do të monitorojë këto çmime dhe nuk do të lejojë që çmimet të rriten në mënyrë jo konsistente me çmimet e importit. Bordi do të ketë detyrë kryesore monitorimin e marzheve të fitimit.

Kjo është një situatë e pazakontë dhe që ka nevojë për monitorim”, deklaroi ajo.

Ministria tha se në ditët e fundit është vërejtur një rritje e çmimit për disa produkte, që jo në të gjitha rastet kanë treguar se kanë ardhur nga rritja në tregjet ndërkombëtare.

Sipas Ibrahimajt, kompani-

sipas saj kanë pranuar të mos kenë marzhe fitimi.

“Ne nuk mund të vendosim çmime arbitrate, pasi operojmë në një ekonomi tregu. Kemi vendosur një garancie që do të përdoret nga tregtarët kryesorë që të blejnë produkte dhe të mos mungojnë në një periudhë afatmesme. Kjo me



itë prezente, por edhe në takimet e zhvilluara më herët, kanë garantuar dhe kanë dhënë dakordësi për të patur marzhe fitimi minimale për produktet bazë të shportës. Disa prej tyre,

qëllim që familjet shqiptare të paguajnë vetëm atë që duhet të paguajnë, pasi sot jemi në situatë lufte dhe të gjithë duhet të përballen me këtë”, deklaroi ministria.

Gripi i shpendëve: Ministria e Bujqësisë merr masa dhe monitoron tregun

Sipas situatës të përditësuar nga zv.ministria e Bujqësisë, Ermira Gjeçi mbi përhapjen e infeksionit të gripit të shpendëve në vendin tone, në datën 27 mars ka pasur një rast të ri të konfirmuar nga ISUV në qarkun Vlorë, fshati Aliban. Deri tani rastet e gripit të shpendëve janë konfirmuar edhe në 6 rrethe të tjera, si Durrës, Dibër, Korçë, Devoll, Divjakë dhe Fier.

“Kemi një rast të ri të konfirmuar. Kemi një vatrë të re infeksioni në qarkun Vlorë. Nuk kemi asnjë stabiliment me drejtim prodhim për mish të infektuar. Jemi në monitorim të vazhdueshëm të të gjithë territorit. Vazhdojmë fushatën sensibilizuese për informimin e fermerëve mbi evi-

dentimin dhe raportimin e rasteve të dyshuara”, pohoi znj. Gjeçi.

Sakaq nga institucionet shtetërore vijon monitorimi në të gjithë territorin e vendit. “AKVMB vazhdon kontrollin në ferma me drejtim prodhimi të vezë, mishi dhe miks, në të gjithë territorin e vendit. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit vazhdon rregullisht kontrollin në të gjithë territorin e vendit. Nuk janë konstatuar shkelje apo problematika.

“Kemi marrë zotim nga bashkitë për bashkëpunim të plotë në lidhje me marrjen e masave për ndalimin e tregimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura të pamiratuara për shitje në zbatim të urdhrin Nr.131, datë 25.3.2022

“Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla”, tha Gjeçi.

Konsumatori shqiptar është e rëndësishme të ndihet i sigurt, se ushqimet në tregun tonë, në qendrat e licencuara janë të kontrolluara. Nuk ka asnjë rrezik nga konsumi i mishit dhe vezëve të gatuna me temperaturë më të larta se 70 gradë Celsius. Nëse konstatojnë shenja të dyshimta për influencë aviare në ferma apo oborre, ju bëjmë thirrje të kontaktoni menjëherë veterinerin zyrtar të zonës ose të telefononi falas në numrin e gjelbër 0800 33 66”.

Krifca: Sjellja konsumatore e stabilizuar, zinxhir tregtar shumë më normal

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca ka takuar importuesit e grurit në bordin e radhës së monitorimit të çmimeve, për të dakorduar mbi çmimin e miellit deri më datën 10 Prill.

Gjendja furnizuese është normalizuar në tregun vendas, edhe pse çmimet në bursën ndërkombëtare vijojnë të jenë të rritura për grurin. Importuesit u shprehën se kontratat e çliruara me Serbinë dhe anijet që kanë ardhur nga vendet jashtë, kanë rritur stoqet.

“Lajmi i mirë është që kemi tregje të hapura në të gjithë botën, pra tregjet janë rihapur dhe kjo na jep një hapësirë tjetër për blerje

nëse ato nevojiten. Lajmi tjetër i mirë është që sjellja konsumatore është ribalancuar, është stabilizuar dhe kështu kemi mundësi që të kemi një zinxhir tregtar shumë më normal se ai paniku i parë që solli një destabilitet në treg”, u shpreh ministria Krifca.

Tashmë Rumania, Hungaria dhe Bullgaria i kanë rihapur tregjet. Ministria Krifca shprehu se në momentin që do jetë e nevojshme, qeveria shqiptare do të japë likuiditet për importuesit e grurit nëpërmjet Fondit të Garancisë.

Ministria Krifca, si anëtare e bordit të monitorimit të çmimeve ka takuar gjithashtu edhe impor-

tuesit e inpueteve bujqësore në vend, ku është dakorduar mbi marzhet për çmimet e uresë, DAP, fosfat, nitrat.

Importuesit u shprehën se çmimet janë të paqëndrueshme në bursat ndërkombëtare çka sjell vështirësi në zbatimin e angazhimeve por se çmimet tona me rajonin, janë 15-20 përqind më të lira. Shoqata përmendi se do të vazhdojnë të ruajnë këtë nivel marzhi deri në takimin e ardhshëm me bordin.

Ministria ka falënderuar për bashkëpunimin ndërsa ka kujtuar se strukturat po monitorojnë rregullisht tregun për të shmanjur abuzime.

HISTORI SUKSESI

Elma Bejo, modeli që frymëzon brezat e rinj

Unë quhem Elma Bejo dhe jam 32 vjeç.

Kam mbaruar universitetin për Mjekësi Veterinare, mirëpo asnjëherë nuk kam punuar në këtë profesion.

Historiku i punëve të mia, ka qenë gjithmonë i lidhur ngushtë me marrëdhëniet njerëzore, nga ku kam punuar fillimisht që nga shkolla e mesme dhe deri në fund të universitetit në sektorin e bareve dhe restoranteve, në pozicionet e shërbimit, marrëdhënien me klientin e deri në menaxhim, dhe nga ku kalova më tej, më së fundi në atë çka va-

Asnjëherë nuk kisha menduar të lija qytetin për fshatin. Kjo ide më dukej pak e "marë" duke marrë parasysh jetën time aktive në shoqëri dhe intensitetin e të jetuarit në jetën me drita të Tiranës, pa kuptuar që një moment më lodhi dhe ndjeva sikur asgjë nga këto nuk mjaftonin dhe s'më bënin më të lumtur.

Dëshira për ndryshim ishte tashmë nevojë, dhe arratisja më e mirë dhe e mundshme e atij

punë vullenare dhe ajo çka më pëlqeu më shumë, ishte ndërthurja e punëve të përditshme, që nuk kishte të bënte vetëm me shërbimin, e cila për mua qe gjë e njohur dhe nuk do më jepte më sensacion të ri, por ishte në kultivim të të mbjellave stinore, mbledhja dhe tharja e bimëve të ndryshme të egra të gjendura në natyrë, gjueti kërpudhash të egra nga më interesantet në llojin e tyre, përpunim i frutave për gliko, rreçelra dhe revani,

imagjinoj të largohem aq larg më, nga nëna natyrë. Toka më kishte munguar edhe pse lindur në qytet.

Unë sot kam kuptuar dhe dua që ajo, toka, që është lënë vetëm e papunuar, ta punoj unë. Unë sot kuptoj, sepse bëj diferencën, që është më e mundshme dhe e prekshme kjo ëndërr, edhe një shtëpie guri në majën e asaj kodre ose në buzën e atij lumi, sesa në qendrën e qytetit me drita.

Kuptova edhe që bashkëf-

shatarët atje, kanë nevojë më shumë për të tjerë që të shkojnë aty tek ta, që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin sesa e ndonjë investimi nga organe qeveritare.

Pikërisht atë që ne sot kemi lënë, fshatin tonë, traditën tonë, historinë tonë, është pikërisht ajo vlera më e madhe e pashfrytëzuar e këtij kombi, që quhet dhe perla e Ballkanit për ndërkombehtarët.

Unë sot kuptoj që pasuri më të madhe gjen në shtëpinë e një

bashkëfshatari sesa në vilën e betonizuar të një qytetari.

Unë sot kuptoj atë çka unë dhe shumë të rinj kemi nevojë, nevojën për punësim, që në qytetin me drita vuan ta gjesht, në fshat po na pret!

Unë mund të thur vargje të tëra, mbase mund të shkruaj edhe ndonjë libër sepse ajo çka mu kthye dhe me e vyer qe dashuria. Ajo që ta mëson zogu i mëngjesit apo muzgu i ngrohtë i natës me të qeshurat pas një dite të lodhshme nën diellin vezullues.

Faleminderit!



zhdoja të isha e mirë, në burime njerëzore ose human resources e thënë ndryshe, në Kompani Shqiptare ashtu sikurse edhe të huaja, remote.

momenti, ishte fashti.

Pata fatin e mirë që në fermën "Grand Albanik", e ndodhur në Ballaban të Këlcyrës, dera qe dhe është gjithmonë e hapur për

njohuri e kulinarisë tradicionale përmetare, zbulim shtigjesh të reja për turistët që na vizitonin, shkëmbim i kulturave me të ftuar që akomodoheshin në bujtinë, etj etj...

Shkova për 3 muaj vere, sot jam në vitin e dytë të qëndrimit tim në fermë, kohë e trajtuar mirë mjaftueshëm që shërbeu edhe si meditim për të ardhmen time.

Koha duket shumë e shkurtër për të gjithë këtë diapazon njohurish, duke paraqitur në këtë moment të jetës time një tjetër dëshirë timen, që nuk e mendoj që do ta kisha ndërë ndonjëherë, nëse nuk do kisha kërkuar më parë tek vetja, atë ndryshimin, që ndryshoi jeten time.

Sot, unë nuk mund ta

Emrat - 12 bosët e vajit që po hetohen për rritjen e çmimit, dyshohen për pakt mes tyre dhe rrezikojnë ndëshkim të rëndë financiar

Autoriteti i Konkurrencës ka nisur hetimin ndaj 9 kompanive të vajit për rritje të çmimit në mënyrë të koordinuar, çmimi i vajit u rrit deri në mbi 100 % pas luftës në Ukrainë

Autoriteti i Konkurrencës njoftoi dje nisjen e një hetimi të thelluar ndaj 9 kompanive të importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit, pasi kanë rritur në bllok çmimin me 7.5% nga muaji shkurt 2022, duke shfrytëzuar panikun nga lufta në Ukrainë, ndonëse kostoja e importit të vajit nuk ka ndryshuar. Autoriteti i Konkurrencës

pas 9 kompanive, të cilat Autoriteti i Konkurrencës po i heton për rritjen e çmimit në mënyrë të koordinuar dhe abuzive?

Kompania kryesore që mbulon 24 % të tregut të vajit, sipas Autoritetit të Konkurrencës, është PDF shpk, themeluar në maji të vitit 2018. Sot, bashkëpronarja kryesore e kompanisë PDF shpk figuron Valbona

Ferra me 25 % të aksioneve. Kompania e tretë, e cila mbulon gjithashtu 18 % të tregut të vajit, është GLOBCOM, themeluar në vitin 2014, ndërsa si bashkëpronarë figurojnë Tedi Beqaj me 63 % të aksioneve si dhe Andi Kodra me 37 % të aksioneve.

Kompania Bomira, e cila mbulon 11 % të tregut, është themeluar në vitin 1999 dhe ka si administrator dhe pronar të vetëm Ylli Aliaj. Rreth 9 % të tregut të vajit i mbulon kompania Ferra & Co sipas Autoritetit të Konkurrencës. Kompania është themeluar në vitin 1995 dhe pronari i vetëm i saj është Isuf Ferra. Kompania Kriket-1, e cila mbulon 6%, është themeluar në vitin 1995 dhe ka si administrator dhe ortak Ilirjan Qytetin.

Kompania Eqerem-934, e cila mbulon gjithashtu 6 % të tregut të vajit, është themeluar në vitin 2009, ndërsa ka si bashkëpronar Kastriot dhe Bujar Mehmetin. Kompania Teuta Durrës, e cila sipas Autoritetit të Konkurrencës mbulon 2 % të tregut, është themeluar në vitin 1994 dhe ka si bashkëpronar Eleni dhe Arben Babameto. Kompanitë rrezikojnë një gjobë të rëndë nëse Autoriteti i Konkurrencës do të krijojë bindjen për marrëveshje të paligjshme dhe të pashpallur mes tyre, për të rritur çmimin e vajit. Teksa çmimi i vajit është rritur në mënyrë të frikshme, mbetet për t'u parë nëse kompanitë do të ndëshkohen apo do të arrijnë të shpëtojnë ashtu si oligarkët e miellit.

KE, 112 milionë euro për fermerët

Fermerët shqiptarë do të mbështeten me një grant IPARD prej 112 milionë eurosh për 6 vitet e ardhshme.

Turqinë (430 milionë euro).

Programet ofrojnë bazën për mbështetjen e BE-së në fushën e bujqësisë dhe zh-

naxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, veprimin klimatik dhe përmirësimin e atraktivitetit të zonave të tyre rurale.

Programet gjithashtu kontribuojnë në objektivat e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane dhe Axyhendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.

Programet IPARD mbështesin investimet në përputhje me standardet e BE-së, duke përfshirë përmirësimin e ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve. Ato ndihmojnë gjithashtu në rritjen e potencialit të rritjes së zonave rurale dhe atraktivitetin e tyre për të parandaluar shpërpullimin nëpërmjet infrastrukturës më të mirë, diversifikimit të aktiviteteve ekonomike që gjenerojnë të ardhura dhe nxitjes së punësimit rural, veçanërisht midis grave dhe të rinjve.

IPARD është një pjesë integrale e strategjisë më të gjerë të para-anëtarësimit të BE-së nën Instrumentin për Asistencën e Para-Aderimit (IPA).



Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë theksoi se, "BE vazhdon të qëndrojë pranë Shqipërisë dhe popullit të saj në këto kohë të vështira!"

Në një njoftim për shtyp të KE thuhet se, Komisioni Evropian miratoi programet e zhvillimit rural (IPARD) nën instrumentin për ndihmën e paraanëtarësimit për Shqipërinë (112 milionë €), Maqedoninë e Veriut (97 milionë €), Serbinë (288 milionë €) dhe

villimit rural për periudhën 2021-2027.

Kjo mbështetje e BE-së, së bashku me kontributet kombëtare publike dhe private, pritet të gjenerojë në total mbi 2 miliardë euro investime në zonat rurale të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.

Me zbatimin e programeve IPARD, vendet përfituese ndjekin objektivat që lidhen me konkurrueshmërinë e sektorit agroushqimor, me-

FED INVEST

FED invest po organizon, në mënyrë periodike, ditët e edukimit financiar dhe digjital me anëtarët e tij dhe të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të mësojnë më shumë lidhur

Ditët e Edukimit Financiar dhe Dixhital të organizuar në degët e FED invest nga data 17 mars - 25 prill

injektuar në ekonomi gjatë 30 viteve të veprimtarisë.

Për më shumë informacion në lidhje me FED invest ju lutemi vizitoni <https://www.fedinvest.al>

me shërbimet e reja të FED invest-it dhe maksimizimin e marrëdhënies me institucionet financiare.

“Dallimi i vetëm thebësor midis suksesit dhe dështimit financiar është se sa mirë i manaxhoni paratë. Është e thjeshtë: për të gjeneruar më shumë para, duhet të dimë t’i manaxhojmë ato”, shprehet T. Harv Eker, shkrimtar. Problemi kryesor sot, në shkallë globale, sidomos në Shqipëri, është mungesa e njohurive financiare, gjë që kushtëzon, përveç të tjerave edhe shkallën e përfshirjes financiare dhe ndërveprimit me institucionet financiare. Edukimi financiar dhe digjital është domosdoshmëri për anëtarët e FED invest-it, të cilët nuk kanë mundësi të ndjekin vetë ritmin e zhvillimit të produkteve financiare dhe teknologjive të reja.

FED invest-i, me përkushtimin e tij në shtimin e vlerave dhe shkallës së kënaqësisë ndaj anëtarësisë, i ka kushtuar rëndësi parësore këtij dimension. Në kuadër të projektit FiAS (Përfshirja financiare e fermerëve të vegjël shqiptarë), janë përgatitur module të edukimit financiar për kreditë, kursimet, llogaritë rrjedhëse,

manaxhimin e investimit në fermën bujqësore, llogaritë rrjedhëse dhe përdorimin e shërbimit FED online. Krahas broshurave edukuese, janë përgatitur edhe video praktike demonstruese, me shpjegime të qarta për përdorimin e këtyre shërbimeve. Të gjitha këto materiale dhe video janë bërë të aksesueshme nga platformat e www.fedinvest.al dhe www.abaonline.al dhe kanalet tona digjitale.

Në mbështetje të nismës së Edukimit Financiar dhe Digjital, u realizua me sukses gjatë vitit të kaluar projekti i Dritares Digjitale, me suportin e Projektit FiAS. Në 7 degë të FED invest-it u pilotua ndërtimi i këndit digjital, ku Këshilltari Digjital prezanton dhe asiston të gjithë anëtarët e interesuar të FED invest-it me materialet e edukimit financiar, si dhe i fton dhe i inkurajon të bëhen përdorues të shërbimeve të FED online dhe abaonline.al.

Këta këshilltarë ofrojnë demonstrime praktike për rubrika të caktuara të platformave përkatëse, si dhe ofrojnë informacion për avantazhet e produkteve të FED invest-it dhe promovojnë produktet e shërbimit e reja të FED invest-

it, siç janë pagesat utilitare etj.

FED invest po organizon takimet vjetore në zyrat e degëve për të promovuar edukimin financiar dhe dixhital për këdo që është i interesuar në menaxhimin financiar. Në këtë ditë, të gjithë anëtarët dhe jo anëtarët e degës mund të marrin materiale edukative falas, të shikojnë pa pagesë përmbajtje edukative mediatike dhe gjithashtu të mirëpritur të bisedojnë me stafin e degës për çështjen e menaxhimit financiar. Ky event do të organizohet nga data 17 mars deri më 25 prill, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të FED invest www.fedinvest.al apo @fedinvest.al në Facebook për orarin e detajuar.

Rreth FIAS

Projekti i FiAS (Përfshirja financiare e fermerëve të vegjël shqiptarë) është një projekt bashkëpunimi teknik, mbështetur nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) dhe zbatuar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri. Projekti synon të përmirësojë përfshirjen financiare të familjeve të vogla fermere në Shqipëri,

duke zhvilluar produkte dhe shërbime të reja financiare dhe jo financiare që i përgjigjen në mënyrë fleksibile nevojave të fermerëve. Kjo po arrihet përmes forcimit të kapacitetit të një Shoqërie Kursim-Kredie, FED invest, e cila ofron shërbime financiare në të gjithë zonën rurale të Shqipërisë.

Lexo më shumë rreth projektit FiAS në <https://fiasproject.org/>

Rreth FED invest

FED invest është një Shoqëri Kursim Krediti dhe është institucioni i parë pionier mikrofinanciar i krijuar në Shqipëri si rezultat i një nisme pilot të Bankës Botërore në vitin 1992. FED invest përfaqëson një kooperative financiare me më shumë se 81 000 anëtarë të shërbyer përmes 62 degëve në të gjithë vendin. Anëtarët e FED invest janë fermerët, sipërmarrësit e vegjël, familje rurale dhe urbane të përjashtuara nga shërbimet financiare bankare.

Si një udhëheqës në ofrimin e zgjidhjeve financiare të përballeshme për popullsinë rurale, FED invest ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin social-ekonomik të Shqipërisë, me mbi 180 000 kredi dhe gjysmë miliardë euro të

Ndikimi i ndryshimeve klimatike në bujqësinë europiane: Kultivimi i grurit dhe misrit do të ulet me 50%!

Një nga gabimet më serioze që mund të bëhet kur mendohet për ndryshimet klimatike është të besosh se europianët, që jetojnë në një rajon të botës që në fund të fundit është i mbrojtur dhe mbi të gjitha i pasur, do të jemi të imunizuar, të paktën në fillim për dëmin më të madh të shkaktuar nga ngrohja globale – dhe se edhe në afat të gjatë kontinenti ynë do të kurset nga problemet më serioze. Në rast se ju jeni një nga ata që ushqeni këtë iluzion, publikimi i pjesës së dytë të raportit të gjashtë të IPCC do t’ju bëjë të ktheheni befasi në Tokë: Europa është në rrezik po aq sa pjesa tjetër e botës, dhe është në veçanti një sektor qendror për ekonominë kontinentale siç është bujqësia që do të vuajë pasojat shkatërruese të klimës së çmendur që na pret në dekadat e ardhshme.

Duke lexuar dokumentin e publikuar më 28 shkurt nga grupi i dytë i punës rezultoi se IPCC identifikon katër Kategoritë kryesore të rrezikut për kontinentin europian. Të katra karakterizohen nga fakti se ato përkeqësohen ndërsa ngrohja globale përkeqësohet: sa më e nxehtë të jetë, aq më afër janë

këto rreziqe për t’u bërë të sigurta dhe për të shkaktuar gjithnjë e më shumë dëme.

• Rreziqet për shkak të valëve të të nxehtë: nëse temperatura mesatare do të rritet me 3 °C (dyfishi i objektivit që kemi vendosur), numri i vdekjeve të shkaktuara nga valët e të nxehtë do të dyfishohet. Për më tepër, valët e të nxehtë do të reduktojnë habitatet e përshtatshme për speciet detare dhe madje tokësore dhe do të ndryshojnë në mënyrë të pariparueshme ekosistemet e kontinentit;

• Rreziqet e thatësirës, e cila veçanërisht për zonën e Mesdheut do të jetë problemi kryesor që do të përballlet në vitet në vijim;

• Rreziqet për shkak të përmbajtjeve më të shpeshta dhe më intensive, për shkak të ndryshimeve në modelet e reshjeve dhe rritjes së nivelit të detit;

• Së fundi, rreziqet për bujqësinë: nxehtësia e kombinuar dhe thatësira do të çojnë, thuhet në raport, në “humbje të konsiderueshme në drejtim të prodhimit bujqësor për shumicën e zonave evropiane”.

Arsyeja pse një klimë e çmendur nuk është e mirë për të korrat është

e lehtë të shpjegohet. Nxehtësia e tepërt dhe mungesa e ujit ngadalësojnë (ose edhe bllokojnë) rritjen e bimëve, valët e të nxehtë intensifikuar rrezikojnë të shkatërrojnë vite të tëra, madje edhe modelet më bujare parashikojnë se Europa Jugore do të largohet në dekadat e ardhshme duke hasur në një rritje dramatike të numrit të ditëve në një vit me burime të pamjaftueshme ujore; me një rritje të temperaturës prej 2 °C, 54% e popullsisë së Europës Jugore do të përjetojë thatësirë, megjithëse jo gjithmonë në forma ekstreme.

Për të mos përmendur që me rritjen e temperaturave, disa kultura do të duhet të braktisen: parashikimet thonë se kultivimi i grurit, misrit dhe panxharit të sheqerit do të ulet me 50% në Europën Jugore. Prandaj, të korrat do të jenë gjithnjë e më të shtrenjta dhe të vështira për t’u mirëmbajtur, me një ulje të sasisë dhe cilësisë së produkteve që vijnë në treg dhe një rritje të njëkohshme të çmimit.

Sipas një raportit të EEA 2019, kjo do të shkaktojë gjithashtu një kolaps të vlerës së tokës, e cila mund të ulet me 80% deri në vitin 2100, duke shkaktuar një braktisje

masive të fushave dhe një biznes jo më fitimprurës. Dëshironi një shembull praktik të këtij procesi? Në vitin 2018, për shkak të një kombinimi të valëve të ngricave të dimrit dhe valëve të të nxehtë të verës dhe thatësirave, Italia humbi 57% të prodhimit total të ullirit; një vit më vonë, Spanja humbi 44%.

Deri tani kemi folur për bujqësinë në Europën Jugore, duke injoruar atë veriore. Ka një arsye: një nga efektet anësore të rritjes së temperaturave është se rajonet që ishin shumë të ftohta disa vite më parë për të mbështetur kultura të caktuara mund të fillojnë të kthehen në bujqësi.

Për shembull, në Saksoni, ku temperatura mesatare është rritur me rreth 2 °C në dekadat e fundit, kanë filluar të shfaqen pemishtet e para me pemë pjeshke dhe kajsji; ndërsa në Angli, Danimarkë dhe Suedi ka edhe nga ata që prodhojnë verë. Problemi është se sipas IPCC-së, humbjet në bujqësinë e Europës Jugore nuk do të kompensohen nga përfitimet e Europës Veriore. Prandaj, zgjidhjet, ose të paktën masat zbutëse, duhet të kërkohen diku tjetër. FCS

Risi turistike, Gjirokastra përfaqësohet në panairin ndërkombëtar New Deal Europe, që zhvillohet më 4 Prill 2022

Turizmi në Focus, Partner për t’u rritur, menaxhimi i destinacionit, janë piketat e mbështetjes që adreson projekti RisiAlbania për zhvillimin e turizmit në rajonin e Gjirokastrës.

Falë kësaj mbështetje portali Visit-Gjirokastra shfaqet për herë të dytë në kopertinën e revistës Travel Weekly!

Zhvillimi i turizmit është prioritet për të gjitha bashkitë e Qarkut Gjirokastër teksa me mbështetjen e RisiAlbania ka marrë jetë shoqata Visit-Gjirokastra që ka tashmë një vizion të qartë për të ardhmen, ndërsa portali visit-gjirokastra.com është një mjet strategjik për të paraqitur asetet e zones. Me portalin Visit-Gjirokastra.com porta kryesore e rajonit për turistët dhe krahinat e largëta po përfitojnë nga promovimi i rajonit si një i tërë, ndërsa angazhohen bizneset dhe shërbimet rurale, një garanci kjo se turistët do të vazhdojnë të kthehen.

Në Gjirokastër po merr jetë inovacioni përmes bashkëpunimit mes sektorit publik dhe privat. Rajoni i Gjirokastrës, është zgjedhur ndër të gjitha vendet

e Ballkanit, për t’u përfaqësuar në panairin ndërkombëtar New Deal Europe, i cili do të zhvillohet më 4 Prill 2022.

NDE është i vetmi panair tregtar i udhëtimeve për Ballkanin dhe Evropën Juglindore, duke u ofruar rajoneve mundësinë për të hyrë në më shumë blerës ndërkombëtarë dhe mundësi rritjeje.

Origjina e qytetit nis me kalanë e Gjirokastrës, e ndërtuar në shekullin IV pas Krishtit. Qyteti u emërua Argyrokastrë, në vitin 1336. Në vitin 1417 u pushtua nga ushtria osmane. Qyteti arriti kulmin e tij gjatë viteve 1800-1830, kur u ndërtuan shtëpitë monumentale të kuvendit. Lagjet e para janë ato të Pazarit dhe Hazmuratë. Karakteristika kryesore e Gjirokastrës është përdorimi intensiv i gurit në ndërtimin e shtëpive, të cilat duken si kala të vogla, rrugët me kalldrëm, që të gjitha të çojnë në Pazar. Këtu mund të vizitoni edhe Xhaminë e Pazarit, e ndërtuar në vitin 1557. Për të gjitha këto veçori, Gjirokastra njihet edhe si “Qyteti i Gurit”.

AKTUALITET

Rama, Bord transparence për çmimet e shportës, kush abuzon i konfiskohet malli

Kryeministri Edi Rama gjatë paradites së sotme ka zhvilluar një takim me përfaqësues të bizneseve furnizuese të ushqimeve, për t'i njohur me masat që ka ndërmarrë qeveria nëpërmjet Paketës së Rezistencës Sociale, ku edhe u tha se pavarësisht se nuk beson te ndërhyrja në treg, tani jemi në kushte të jashtëzakonshme dhe një gjë e tillë është e domosdoshme.

Kryeministri Edi Rama tha se do të ngrihet një bord për administrimin e çmimit të shportës ku nuk do të lejohen abuzimet, dhe se kush nuk respekton çmimin e vendosur humbet mallin.

“Më ka shqetësuar fakti që shumica ia hedh fajin pakicës,

pakica ia hedh fajin shumicës, në diskutimin mbi çmimet. Dhe për të mos pasur hedhje fajit nga njëri-tjetri, do futemi dhe ne. Do të krijojmë një bord për çmimet kryesore. Ky bord i përbashkët do të përbëhet nga përfaqësues të qeverisë dhe përfaqësues të shumicës dhe pakicës dhe çmimet e ushqimeve bazë do të vendosen aty dhe askush nuk do të tolerohet të vendosë çmime të ndryshme. Ai që do vendosë çmime të ndryshme do të humbasë pro-

dhimin, do t'ia konfiskojmë komplet”, deklaroi Rama.

“Jo me arbitraritete, por me ligj dhe zakon do të kalojmë akt normativ dhe i gjithë ushqimi do të konfiskohet, nëse dikush do të luajë me çmimet. Nuk mund të vendosen çmimet sipas dëshirës. Do të hyjmë ne për të bërë transparencën e çmimeve”, theksoi Kryeministri.

Dhe sigurisht, shtoi Rama, “siç po bëjmë me karburantet, nuk është qëllimi që të vendosim çmime arbitrare, se naty-

risht që të gjithë duam çmimet më të ulëta, po nuk i vendosim dot çmimet ne sipas dëshirës. Kemi jashtëzakonisht shumë dëshirë ne që t'i ulim çmimet aty ku ishin, po këtë nuk e bëjmë dot. Se nuk do hyjmë për këtë punë aty. Por do hyjmë aty që bashkë me ju të bëjmë një herë transparencën e çmimit ku e ke marrë, sa e ke marrë dhe sa do shitet”.

“Dhe nuk jam unë për teori-në meqë është blerë përpara tre muajsh, atëherë duhet të shitet sa është blerë para 3 muajsh, se

nuk funksionon kështu ekonomia. Aq më tepër nuk funksionon kështu lufta. Se nëse do ndodhte kështu, atëherë me se do t'i blini ju të tjerat pastaj që do t'i sillni prapë. Se i ke marrë atëherë dhe do i shesësh si atëherë, kjo është histori për gjyqë partizane, që nuk bëjnë pjesë fare në filozofinë tonë”, tha Rama.

“Ama, transparente. Ju do të paraqisni të gjithë strukturën logjike sesi, bazuar mbi shifra, se sa ju del. Dhe aty do të vendoset. Sigurisht që marzhi i

fitimit do të ngrihet në një pikë që t'ju lejojë juve vazhdimin e operacionit, por jo që ju të dilni me fitim, njësoj siç keni dalë me fitim, se kjo nuk ka sens. Sepse që ju të dilni me fitim, siç keni dalë gjithmonë me fitim, duhet të vuajë këtu një popullsi e tërë. Por jo, në këtë nuk mund ta lejojmë. Mbi vuajtjen e njerëzve askush nuk mund të fitojë në këtë kohë skandaloze”, tha Rama.

“Dhe natyrisht, askush nuk ka të drejtë që të kërkojë prej jush që ju të humbisni, sepse nëse ju do të humbisni sot, nuk do mund të jepni më shërbim nesër. Dhe kjo mund të jetë një gjë e tmerrshme fare në vijim”, theksoi Rama

Kriza e shtrenjtimit të karburanteve dhe energjisë po vështirëson aktivitetin e prodhuesve, që sërish janë një hap para rritjes së çmimeve të produkteve, duke rrezikuar tkurrjen e shitjeve deri në mbylljen e fabrikave.

Kriza e tregjeve ndërkombëtare pas luftës Rusi-Ukrainë ka prekur edhe importuesit e mallrave të konsumit, të cilët po furnizojnë me vështirësi dhe kosto të lartë tregun vendas.

Prodhuesit pohojnë se shtrenjtimi i çmimeve nga rritja e kostove (karburantet dhe energjia zënë 20-40% të kostos) ka ulur konsumin, ndërsa janë të pambrojtur nga luhajtjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Për këtë arsye, shoqatat e bizneseve dhe sipërmarrës kërkojnë njëzëri ndërhyrjen e qeverisë në heqjen e taksave të naftës dhe uljen e nivelit të TVSH-së te mallrat bazë të shportës ushqimore. Përfaqësues të sektorit të blegtorisë kërkojnë ngrijen e paketës fiskale deri në kapërcimin e krizës dhe rritjen e subvencioneve për fermerët.

Kërkohet ngrijja e Paketës Fiskale 2022

Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Agim Rrapaj, ka kërkuar që paketa fiskale, e cila hyri në fuqi në janar 2022, duhet të ngrihet deri në normalizimin e pasojave të krizës, pasi po prek bujqësinë dhe sektorët e ekonomisë së ushqimit.

“Duhet të zbatohet paketa e mëparshme fiskale. Masa e propozuar eliminon një nga shkaqet kryesore të krizës që janë ndryshimet fiskale. Kthimi i taksave në nivelet e mëparshme është lehtësisht i zbatueshëm, por edhe e provuar që do të amortizojë rritjen e kostove të prodhuesit vendas nga shtrenjtimi i çmimeve”, thekson z. Rrapaj.

Kryetari i Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Prodhuesve Vendas, Ervin Resuli, pohon se aktualisht fermerët kanë vetëm furnizime voluminoze të ushqimeve për kafshët (kashtë dhe bar) ndërsa u mungon soja dhe produkte të tjera, për shkak të shtrenjtimit të lartë të çmimeve.

“Kriza e rritjes së çmimeve ka rënduar më shumë situatën për sektorin e blegtorisë. Shumë fermerë, jo vetëm që

Çmimet e produkteve të shportës nuk e ndalin rritjen. Shtrenjtimi është ndikuar nga rritja e çmimit të naftës, energjisë, grurit dhe lëndëve të tjera në tregjet botërore. Shoqatat e bizneseve prodhuese dhe importuesit kërkojnë heqjen e taksave të karburantit dhe përgjysmimin e TVSH-së së shitjes, masë e menjëhershme fiskale që do të rrisë konsumin dhe do të mbajë fabrikat në punë

gjenden në vështirësi për sigurimin e ushqimit për kafshët, por edhe po arrijnë t'i çojnë në thertore. Për të ndihmuar sektorin, qeveria duhet të ndërhyjë për vendosjen e një çmimi fiks për naftën e fermerëve në vlerën 1 euro/litri, sa në nivelet e vendeve të rajonit.

Të vendoset gjithashtu tavan për çmimet e inputeve bujqësore. Vendorsja e TVSH-së 10% tek inputet bujqësore me paketën e re fiskale ka ndikuar te shtrenjtimi i çmimeve. Kërkohej edhe riformulimi i skemës mbështetëse dhe heqja e të gjitha skemave që nuk shkojnë drejtpërdrejt te fermeri.

Dyfishimi i financimit të skemës mbështetëse si Kosova dhe rajoni, si dhe heqja e dyshemesë e tavanit për skemat mbështetëse (numri i krerëve dhe sipërfaqja e të mbjellave).

Ulja e TVSH te produktet ushqimore

Përpunuesit e qumështit dhe sipërmarrës të importit të vajit të lulediellit kërkojnë uljen e TVSH-së së pagueshme nga 20% në 6% apo 10% si masë e menjëhershme për të shpëtuar prodhimin vendas dhe për të ulur çmimet e produkteve ushqimore.

Prej disa muajsh, Shoqata Industria e Përpunimit të Qumështit përsërit kërkesën për reduktimin e TVSH-së 6% në shitje, si masë fiskale që do të frenonte rritjen e çmimeve për konsumatorin dhe do të rriste shkallën e konkurrueshmërisë ndaj produkteve të importit.

Përfaqësuesi i kompanisë “Erzeni”, Saimir Begaj, tha për “Monitor” se ulja e TVSH-së në shitje ose kthimi i TVSH-së së kreditueshme, siç ka qenë më parë do të ishte një mundësi për të ekuilibruar rritjen e çmimeve, e ndikuar nga shtrenjtimi i kostove.

“Këtë vit ka rritje të lartë të çmimeve të qumështit, për shkak të rritjes së çmimeve të lëndëve të para të fermerëve dhe mungesës së subvencioneve ndaj tyre.

Çmimi i qumështit të deles është 20% më shumë se vjet, ai i lopës 30%, i dhisë mbi 30%. Rritja e çmimit të qumështit, të karburanteve, energjisë dhe

lëndëve të para ka shtrenjtuar kostot e prodhimit të fabrikave të qumështit.

Në këtë situatë është e domosdoshme që institucionet shtetërore të rrisin subvencionet e fermerëve, pasi ushqimet për kafshët janë trefishuar. Skema e TVSH-së së kreditueshme ishte një masë fiskale që arrinte të ekuilibronte çmimet. Heqja e saj duhet të zëvendësohet me rritjen e subvencioneve të blegtorisë, të njëjta me skemat e Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës.

Një masë tjetër fiskale që do të ndihmonte sektorin dhe do të zbuste presionin për rritjen e çmimeve të produkteve të konsumatorit do të ishte ulja e TVSH-së në blerje nga 20% në 6%”, thekson z. Begaj. Shtrenjtimi i çmimit të naftës ka shtuar kostot e përpunuesve për shpërndarjen e produkteve të bulmetit në dyqanet e shitjes.

Për të amortizuar rritjen e kostove, bordi drejtues i kompanisë është duke shqyrtuar draft-vendimin për ndërprerjen e furnizimit një ditë në javë me produkte bulmeti.

Kjo masë mund të ndikojë te shitjet, pasi klientët nuk kanë mundësi magazinimi të bulmetit, për këtë arsye, furnizimet janë të përditshme me produkte të freskëta. Është e nevojshme që për të ulur kostot nga shtrenjtimi i naftës të ndërhyhet me masa të reja fiskale. Taksa e qarkullimit të karburantet duhet të hiqet”, thotë z. Begaj.

Aktorë të tjerë të tregut kanë paralajmëruar rritje tjetër 10% të çmimeve të bulmetit për të përbashkët shtimin e kostove nga shtrenjtimi i naftës dhe energjisë. Çmimet e produkteve të bulmetit nisën rritjen 10% nga korriku 2021 për shkak të shtrenjtimit të energjisë dhe plastikës në tregjet e huaja.

Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve fiskale për heqjen e skemës së TVSH-së së kreditueshme, shumë kompani përpunuese u përballën me shtrenjtimit të çmimit të qumështit të grumbulluar nga fermeri 10%. Rritja e çmimit të qumështit të grumbulluar,

të energjisë dhe karburantit i detyroi përpunuesit që nga 1 janari 2022 të ngrënë çmimet e bulmetit me 10%.

Pak ditë më parë, Shoqata e Industrisë së Përpunuesve të Qumështit kërkoj heqjen e akcizës 6 lekë/litër për gazin që nis zbatimin nga 1 korriku 2022. Nga viti 2018, akciza ishte zero.

“Kjo është një taksë që do të rëndojë më tepër industrinë përpunuese të qumështit, pasi do të llogaritet mbi sasinë e përdorimit të gazit dhe çmimit. Nuk është çudi që nga ndryshimet fiskale, pas përfundimit të luftës Rusi-Ukrainë, kur çmimi i gazit të stabilizohet, shkalla e akcizës do të jetë e njëjtë me çmimin e shitjes”, pohoi drejtori ekzekutiv i shoqatës, z. Aldo Hoxha.

Përpunuesit e qumështit kërkojnë edhe heqjen e 10% TVSH për inputet bujqësore të importit, që prej 2018-s ishte zero, pasi ato përfshijnë të gjitha lëndët e para që fermerët përdorin për kultivimin e tokës dhe mbajtjen e kafshëve, të cilat kanë ndikuar te rritja e kostos së prodhimit dhe tregimit të qumështit.

Përpunuesit e qumështit kërkojnë që në sektorët që do të mbështeten nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2022, të përfshihen patjetër skemat e subvencionimit si: mbështetje direkte 10 lekë për litër qumësht pa limit, të dorëzuar në pika të licencuara grumbullimi ose përpunimi; 10,000 lekë për çdo krerë lopë pa limit të numrit të krerëve; 2,500 lekë për çdo krerë dele/dhi pa limit të numrit të krerëve; 4,500 lekë për krerë lopë pa limit, nëse e dërgon në thertore të licencuar; 800 lekë për krerë dele/dhi pa limit, nëse e dërgon në thertore të licencuar; 20,000 lekë/ha pa limit për tokë të mbjella me misër, grurë, etj. (plus 10,000 lekë nëse përdoret farë e certifikuar).

Edhe importuesit e vajit të lulediellit në vend e kërkojnë reduktimin e TVSH-së në shitjen e produkteve të shportës. Prej disa vitesh, rafineritë e prodhimit të vajit të lulediellit në Shqipëri nuk funksionojnë,

për shkak të kostove të larta të vënies së tyre në punë.

Tregtarët e vajit furnizohen nga importi me vaj të përpunuar, që më pas ambalazhohet në vend. Tedi Maraj, drejtori i përgjithshëm i kompanisë “Erbiron sh.p.k”, e cila ka ekskluzivitetin e importit të vajit të botiluar hungarez “Floriol”, tha për “Monitor” se në këtë situatë kur çmimet e furnizimeve janë shtrenjtuar, qeveria duhet të ndërhyjë për uljen e TVSH-së te mallrat e shportës.

“Çmimi i vajit të lulediellit nga Hungaria për muajin prill do të rritet në 2,8 euro/litër nga 1,8 euro/litër që është për marsin, pa përfshirë kostot e transportit që janë rritur 64% krahasuar me janar-shkurt 2021.

Për të përbashkët shtrenjtimitin e çmimeve, qeveria duhet të reduktojë TVSH-në e shitjes së produkteve ushqimore nga 20% në 10%, një masë e menjëhershme për të amortizuar rritjen e çmimeve, ndërsa TVSH-ja për produktet e luksit të mbetet e pandryshuar”, thotë z. Mara.

Për muajin mars, çmimi i vajit “Floriol” i importuar nga Hungaria u tregtua me pakicë 330 lekë/litër nga 249 lekë/litër në muajin shkurt (rritja 32,5%). Rritje në të njëjtat nivele shënoi edhe vaji i misrit, duke arritur çmimin rekord të 350 lekë/litër.

Sipas tij, rritja e çmimit të vajit të lulediellit në Hungari është për shkak të ndërprerjes së eksporteve të vajit nga Ukraina, Rusia dhe Serbia pas fillimit të luftës. “Kërkesa e lartë e vendeve të Europës, e ndikuar edhe nga paniku për mospësigurimin e vajit, më tepër po përballohet nga Hungaria.

Shumë furnitorë nga Italia dhe Kosova janë në vështirësi për gjetjen e furnizimeve, për këtë arsye kanë kërkuar vajin nga ne, por e kemi të pamundur t'i furnizojmë, pasi parësor është tregu vendas, pavarësisht kostos së lartë”.

Rusia, Ukraina, Hungaria, Serbia dhe Bullgaria janë furnizuesit kryesorë të tregut shqiptar me vaj ushqimor lulediellit. Më pas e ndjekin edhe shtete

të tjera të Europës, si Italia, Gjermania dhe Greqia, por në sasi më të vogël.

Sipas të dhënave të INSTAT, importet e “Vajra dhe dhjamëra kafshore, apo vegjetale” nga Rusia u rritën me 11% në vitin 2021, në krahasim me një vit më parë, duke përbërë 17% të totalit. Në të njëjtën linjë u rritën importet nga Hungaria (3,5%), Italia (4%), ndërsa importet nga Ukraina pësuan rënie 7%.

Kërkesat për uljen e taksave

Presidenti i Shoqatës së Eksportuesve, Alban Zusi, tha për “Monitor” se në këtë situatë, kur shtrenjtimi i çmimit të karburanteve dhe energjisë ka shtuar kostot e prodhimit dhe ulur konsumin, institucionet shtetërore duhet të ndërhyjnë me heqjen e taksave të karburanteve dhe TVSH-së për produktet e shportës.

“Në këtë situatë, qeveria duhet të heqë dorë nga koncepti i mbledhjes së taksave, që më pas do t'i përdorë ato për të mira publike ndaj qytetarëve. Sot qytetarit duhet t'i lihet më shumë para në dorë për të blerë produktet kryesore të shportës.

Sot kemi nevojë që paratë të mbeten në duart e njerëzve që të rritet konsumi, i cili ka rënë për shkak të ngrijtes së çmimeve, që paratë e qytetarëve të shkojnë për blerjen e prodhimeve vendase, të cilat zënë pjesën kryesore të shportës ushqimore.

Kjo është e vetmja mënyrë që do të mbajë fabrikat në punë, do t'i shpëtojë ato nga mbyllja dhe nga shkurtimi i vendeve të punës.

Situata e shtrenjtimit të çmimeve nuk mund të zgjidhet me disbursime të buxhetit, pasi mekanizmat e tij janë shumë të ngadalshëm për të pasur efekte të menjëhershme të konsumit. Duke pasur më shumë para në duar, do të jetë vetë konsumatori ai që do të zgjidhë krizën.

Për këtë arsye është e domosdoshme që, për një periudhë 3-mujore, të pezullohen apo të zerohen taksat e produkteve të konsumit dhe të hiqen taksat e karburanteve.

Zbatimi i kësaj mase të jetë i përkohshëm, deri sa të kuptohet se çfarë po ndodh dhe të kapërcehet situata e rritjes së kostove të prodhimit dhe çmimeve për produktet e konsumatorit”, nënvizon z. Zusi.



SHOQATAT ANETARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në
7 MILIONË
Lekë



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

BUJQËSIA BIOLOGJIKE

Mendime për zhvillimin e përshpejtuar të bujqësisë dhe të fshatit

(Në kuadrin edhe të ftesës së Qeverisë, drejtuar publikut për konsultime mbi problemet ekonomiko-sociale të vendit)

Përgatiti Prof. Ass. Enver ISUFI
Instituti i Bujqësisë Biologjike, Durrës



Prof. Ass. Enver ISUFI

Rezervën më të madhe të rezultateve positive në çdo fushë të veprimtarisë njerëzore, e gjejmë tek shprehja filozofike popullore “Mat shtatë herë dhe pre një herë”.

Kjo thënie filozofike popullore, është edhe baza nga lindi demokracia e strukturuar me institucione demokratike, e deri te parlamenti, i cili është organi më i lartë, ku mendohet

momentin, dhe jo për pasojat ekonomiko-sociale të mungesës së një bujqësie të zhvilluar me të gjitha elementët e infrastrukturës së saj.

Shqiptarët e dinë që një ditë treni Europian do të vijë t'i marrë në “stacionet” tona, por kur treni vonohet me vite e dekada për të ardhur, njerëzit nuk presin dhe largohen, e largohen nga Shqipëria.

“Europën ta ndërtojmë këtu” dhe jo ta gjejmë në ato vende ku kemi eksportuar dhe po eksportojmë forcat fizike dhe intelektuale të kombit. Shumë elementë të kësaj Europe, tashmë i kemi ndërtuar në Shqipëri, problemi shtrohet që të elementet të tjerë të rinj që na duhen, nuk presin më vonesa, ndryshe humbasim edhe ata që kemi arritur. P.sh. nëse në zonat fshatare, kemi investuar me shumë vonesë për të ndërtuar një rrugë, një kanal ujitës, ose një shkollë, edhe kur i ndërtojmë ato, fshati boshatiset, dhe atje nuk ka më as bujqësi, as nxënës shkollash.

2. Ministria e Bujqësisë, nën shembullin e Komisionit të Ekspertëve për mirëmenaxhimin e Pandemisë globale COVID 19, mund të krijojë një komision të ngjashëm konsultues.

Ky komision ekspertësh, kontribuon me ide në reformat dhe ligjet, të cilat përgatiten për zbatim në fushën e bujqësisë dhe të mjedisit. Sa shumë diskutime mediatike dëgjojmë natë për natë për politikën, ende nuk ka diskutime të tilla për biseda bukëdhëse mes ekspertësh të fushave të ndryshme të bujqësisë dhe blegtorisë.

A u diskutuan gjerësisht p.sh. se si mund të riorganizohen më mirë zyrat e bujqësisë në të gjitha nivelet, shërbimet e tilla si shërbimi veterinar, shërbimi mbrojtjes së bimëve, shërbimi këshillimor. Cilat studime do të ishin të nevojshme të kryheshin në bujqësi, marketing, veterinar, në mbrojtjen e bimëve. Cilat studime themelore do t'u kërkoheshin Universitetit Bujqësor dhe cilat institucione shkencore të Ministrisë së Bujqësisë. Cilat do të ishte struktura e organizimit të drejtorive dhe sektorëve në Ministrinë e Bujqësisë. etj. Televizioni Publik Shqiptar (TVSH), e ka

për detyrë t'i mbajë gjithmonë të ngritura tavolinat e debateve ekonomike në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit të fshatit.

3. Në lidhje me inputet e bujqësisë, do ishte mirë që të hartohej një listë e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve (PMB), si dhe plehrave organike të prodhuara nga industria, të cilat janë miqësore me mjedisin. Vetëm kjo listë e hartuar nga një grup ekspertësh të lejoheshin të futen nga importi pa tarifë doganore. Me dëshirën e mirë, Qeveria, i hoqi për disa vite këto tarifa doganore, por tregtarët nuk reagojnë në uljen e çmimeve të shitjes tek fermerët.

Mbase me farërat dhe fidanat, mund të ishte pak më ndryshe, mund të lihej të pagahej vetëm gjysma e tarifës doganore, me idenë që të nxisim sipërfaqet e mbjella.

4. Institucionet shkencore të Ministrisë së Bujqësisë, të cilat para vitit 2006, mbanin statusin “Institute”, që nga ai vit e deri me sot mbajnë statusin “Qendra të Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)”. Le të marrin përsëri statusin “Institute” dhe të fillojnë edhe rinovimin e tyre me ekspertë të rinj me cilësi të mira profesionale. Një ligj për shkencën bujqësore dhe një buxhet më i arsyeshëm për shkencën në bujqësi, lipset të merren në konsideratë.

5. Të rifillonte botimi i revistës “Bujqësia Shqiptare”, si një botim i Ministrisë së Bujqësisë. Botimi i saj u ndërpre në vitin 2010. Medja elektronike dhe rrjetet sociale, nuk do të zëvendosojnë kurrë librat dhe revistat e shkruara. Ato janë edhe histori, janë arshivë.

6. Qeveria mendoj se duhet të hartojë një strategji për transformimin e bujqësisë shqiptare drejt bujqësisë biologjike «Bio Albania». Bumi turistik i sotëm, do njohë kulme të reja, sidomos me zgjerimin e aeroportëve shqiptarë. Koncepti «Për një Shqipëri me ushqime biologjike dhe mjedis të shëndetshëm» është një proces i gjatë. Sa më shpejt të fillojë të zbatohet, aq më e shkurtër do të jetë koha kur ky realitet do të preket nga konsumatori vendas dhe ai i huaj.

Ajo që duhej bërë është të vendosen piketa për t'u arritur vit pas viti. P.sh. deri në vitin 2030, bujqësia jonë të ishte në 5 % të sipërfaqes së saj, e certifikuar si bujqësi biologjike dhe 10% e sipërfaqes të jetë certifikuar me standardet e bujqësisë së mirë Global GAP (Praktikat e Mira Bujqësore).

7. Mendoj se duhet deversifikuar ekspertiza duke përfshirë ekspertët privatë dhe ato të angazhuar në organizatat jo qeveritare. Hartimi i një data baze me emrat e ekspertëve sipas fushave

të ekspertizës, ekspertë të cilët do të ishin një burim konsultimi dhe projektsh në zbatim të politikave kombëtare bujqësore. Koncepti i partneritetit Shtet-Privat duhet të zbatohet edhe në ekspertizat e vogla, jo vetëm në projektet e mëdha.

8 - Kontrata e Ministrisë së Bujqësisë me studentët më të mirë të Universitetit të Bujqësisë, në vitin e tretë dhe të katërt të studimeve, do të krijonte një gjeneratë të re ekspertësh që do të shërbenin në rangjet e larta të administratës, institucionet shkencore etj. Me këto studentë, në kontrata të vendosen kushte, që të paktën 3- 4 vite, të mos lejohen të largohen nga vendi, pas kësaj periudhe, le të bëjnë çfarë ata dëshirojnë. Kjo krijon vazhdimësi të administratës me specialistë me nivel të mirë profesional. Le të gërshetojmë interesin personal me interesin kombëtar edhe në këtë pikë. Nuk po shkojmë me detyrim në ushtri, por të paktën të shkojmë për 3-4 vite, aty ku ka nevojë shoqëria edhe si mjek, agronom, mësues, oficer, inxhinier naftë, minierash, regjizor, aktor etj. etj. Jemi kthyer në “inkubatorë” të fuqisë punëtore për të tjerët dhe për vendin tonë.

9 - Të krijohet të paktën një shkollë bujqësore e tipit perëndimor, e cila të përgatisë menaxherë të kompletuar të ekonomisë bujqësore private; menaxherë të prodhimeve bujqësore ekologjike, të mjedisit, agroturizmit, hoteleerisë, gastronomisë, pejsazhit bujqësor etj.

10- Ringritja e Qendrës së Informacionit Bujqësor, me shtypshkronjën e saj, ku të botohen që nga fletëpalosjet e deri revistat, librat, katalogjet e manuale, e postera. Kjo qendër të specializohet për përgatitjen e videove dhe DVD-ve profesionale për shërbimin këshillimor dhe vetë fermerët.

Shqipëria ka një sipërfaqe toke, sa një fermë e madhe në vendet e zhvilluara dhe s'ka pse ta coptojë informacionin bujqësor. Kjo qendër do të standardizojë cilësinë e informacionit dhe do të presë rrugën amatorizmit në këshillime, të cilat sot lulëzojnë kudo.

11- Ngritja e rrjetit të prognozë-sinjalizimit në mbrojtjen e bimëve me aparatura elektronike dhe mjete moderne për monitorim të isekteve. Në këtë kuadër edhe toka bujqësore t'i nënshtrohet analizave për lëndët ushqyese, me synimin e plehërimit shkencor të tokës dhe të bimëve dhe mbajtjen nën kontroll nga mabetjet kimike në tokë, ujëra dhe produktet bujqësore.

12 -Organizimi i takimeve kombëtare të përvitshme, ku të analizohen në detaje prodhimi i

bimëve kryesore. P.sh. Konferenca kombëtare “Ulliri, 2021”, ose “Perimet, 2021”, “Frutat 2021” e për çdo vit kështu.

Në këto takime, analizohen në të gjitha praktikat agronomike, që nga fara, fidani, kultivarët, rajonizimet e mbjelljeve, përdorimi i plehrave, mbrojtja e bimëve, marketingu, infrastruktura përpunuese, mbështetja financiare nga shteti dhe nga projektet e BE-së, shërbimi këshillimor, studimet bazë dhe ato të zbatueshme në nivel ferme, mbulimi me literaturë dhe mediat elektronike etj.

Takime të tilla vënë në lëvizje të gjithë zinxhirin e vlerave shkencore, që nga Universiteti Bujqësor, institutet e Ministrisë së Bujqësisë, institutet private.

13 -Një herë në katër vjet të organizohen Kongreset e Bujqësisë dhe Zhvillimit të Fshatit, në të cilët analizohen aktualitetet dhe perspektivat e zhvillimit të bujqësisë dhe fshatit shqiptar. Konferenca kombëtare treditore për bujqësinë është zhvilluar në vitin 1975. Punimet e konferencës u botuan në një libër me 808 faqe.

14-Në çdo Bashki, në sheshet e tyre kryesore të zhvillohet tregu bujqësor, fillimisht një herë në muaj, më vonë një herë në javë dhe kur të jetë krijuar infrastruktura e këtij tregu mund të zhvillohet në dy herë të javë, ashtu siç ndodh prej vitesh në sheshet e ngashme të qyteteve të vendeve europiane.

15- Bashkitë kryesore të ndërtojnë qendrat e tyre të Pannaireve Bujqësore dhe jo vetëm bujqësore, ku të demonstrohen prodhimet dhe zhvillimet e reja teknologjike të perspektivës.

16- Në lidhje me sistemet e bujqësisë, të hartohen strategji kombëtare për shmangien graduale të bujqësisë së zakonshme (konvencionale) dhe kalimin plotësisht në bujqësi të integruar dhe në atë biologjike. Një plan i tillë veprimi shkallëzohet në objektiva, të cilat duhet të arrihen brenda 5, 10, 15 dhe 20 vjetëve.

Vendet e vogla si Shqipëria, mirëqenien e qëndrueshme mund ta sigurojnë kur në qendër të çdo reforme vendoset “CILËSIA E USHQIMIT DHE E MJEDISIT”. Këto dy faktorë sigurojnë një shoqëri të shëndetshme dhe të qëndrueshme.

Modernizimi i bujqësisë kërkon të njëjtin kujdes dhe investime, ashtu si kujdesi dhe investimet për mjekësinë.

Komisioni dhe Parlamentit Europian, në vitin 2021, mori një vendim historik, prodhimi biologjik në shtet e BE-së deri në vitin 2030 të katërfishohet. Konkretisht nga 8, 5 % të sipërfaqes së përgjithshme bujqësore që është sot, të arrijë në 25 % tetë vite më vonë.

Këtë nismë të guximshme të BE-së, e nxitë pandemia globale COVID 19 dhe ngjarjet gjithnjë e më të rënda të motit të shkaktuara nga ngrohja globale.

Kur këtë vendim e marrin vendet e industrializuara, të cilat kanë boll mallra të tjera për në treg, si duhet të veprojë Shqipëria, ku bujqësia, turizmi dhe agroturizmi kanë një peshë shumë të madhe në ekonominë kombëtare?

Arrihet pikërisht me re-forma të tilla, të cilat sigurojnë një barazpeshë mes interesave EKONOMIKE - EKOLOGJIKE - SOCIALE.

17 - Do të ishte e justifikueshme të ngrihej një Institut Shtetëror që mund ta kishte emrin “Institut i Zhvillimeve Strategjike Ekonomike” Ky institut të ishte nën rrjetin e Instituteve të Akademisë së Shkencave. Studimet e këtij instituti do të ndihmonin vendimmarrjen për investimet e mëdha me interes mbarëkombëtar.

18 - Një institut shtetëror për mekanizimin në bujqësi, do të ndihmonte si në diversifikimin e mekanizimit të madh dhe të vogël, ashtu edhe në aftësimin e specialistëve dhe vetë fermerëve në përdorimin profesional të mekanizimit në bujqësi. Për fermat tona të vogla nuk duhet të nënvlerësohet mekanizimi i vogël i proceseve të punës në bujqësi, i cili vitet e fundit është modernizuar shumë.

19 - Burimet e reja të naftës dhe mineraleve të tjera të zbuluara tani e më vonë, të ishin pjesërisht, ose plotësisht pronë e shtetit.

20 -Të hartohet një strategji kombëtare për prodhimin e grurit si ushqim bazë për njerëzit dhe misri si ushqimi bazë për blegtorinë. Në 60-70 % të sasisë së tyre të prodhohej nga bujqësia jonë. Gruri nuk është vetëm ushqim për njerëzit, por edhe ushqim për blegtorinë dhe shpendët, është kashtë për blegtorinë dhe industrinë, qarkullim bujqësor për bimët e tjera, është përvojë në shkencë e prodhim, cilësi ushqimi, gjelbërim i territorit duke ndihmuar në mjedis dhe në kufizimin e ngrohjes globale.

Grurin dhe misrin jo të gjitha vendet e prodhojnë në të njëjtën kosto, por të gjitha vendet e industrializuara e prodhojnë vetë bukën e popullit të tyre, ndonëse kanë shumë më tepër teknikë e teknologji për të eksportuar, krahasuar me Shqipërinë që të gjitha materialet industriale i importojmë nga jashtë.

Ky është sistemi i PARASË dhe jo sistemi i MALLIT. Sa më shumë para të kursjëm nga importimi e ushqimeve, duke i prodhuar në vend, aq më shumë para do të na mbeten për të blerë ato mallra që nuk i prodhojmë në Shqipëri. Progresi i madh i bërë në eksportimin e perimeve, agrumeve, bimëve mjeksore, vajit të ullirit, ujit të pijshëm etj., kanë kursyer sasira të mëdha parash, por problemim po e trajtojmë, se ka akoma shumë rezerva për të shtuar prodhimin vendas, si të drithërave, ashtu edhe të produkteve të tjera bujqësore dhe blegtorale.

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

(Vijon nga numri i kaluar)

Të ushqyerit e brojlerëve

Të ushqyerit është një faktor shumë i rëndësishëm për të shfrytëzuar në mënyrë sa më të plotë aftësitë prodhuese të shpendëve, për të marrë prej tyre prodhime të larta vezësh apo mishi me kosto sa më të ulët. Ushqimi dhe konsumi i tij është shumë i rëndësishëm në rritjen brojlerve, meqenëse shpenzimet për ushqimin përbëjnë rreth 70 % të kostos totale të mbajtjes së tyre. Është e rëndësishme që shpendët të tresin dhe të shfrytëzojnë në mënyrë sa më efikase ushqimet, lëndët ushqyese të racionit të tyre. Racionet e balancuara përmbajnë burime të mjaftueshme të gjithë lëndëve ushqyese të njohura duke siguruar kështu një prodhim maksimal. Prodhimi i mishit është në varësi të ushqyerit. Sasia e ushqimit që ato marrin varet nga kërkesat që ato kanë për lëndë ushqyese. Këto kërkesa varen direkt nga masa trupore, moshja, raca dhe nga niveli i prodhimit të shpendëve. Këta konsiderohen edhe faktorë të brendshëm që ndikojnë direkt në kërkesën për lëndë ushqyese, pra edhe në konsumin e ushqimit. Përveç këtyre në konsumin e ushqimit ndikojnë edhe faktorë të tjerë, që konsiderohen të jashtëm dhe që janë mjaft të rëndësishëm. Niveli energjetik i ushqimit ndikon në sasinë e ushqimit të ngrënë nga shpendët, ai është rregullator i sasisë së ushqimit që konsumojnë shpendët, për rrjedhojë edhe i sasisë së lëndëve ushqyese që ato marrin me të. Për të arritur performanca të mira, racionet ushqimore të brojlerve, duhet të formulohen për të dhënë balancën e duhur të energjisë, proteinave, aminoacideve, mineraleve dhe acideve yndyrorë esenciale. Një racion i ndërtuar mirë duhet të përmbajë të gjitha lëndët ushqyese të nevojshme në sasi të, dhe raportet e caktuara me njëra tjetrën, si edhe me energjinë. Këto racione plotësojnë normalisht nevojat e brojlerve në lëndë ushqyese dhe njëkohësisht sigurojnë një shfrytëzim më të mirë të ushqimit. Një rol të madh në konsumin e ushqimit për brojlerët luan edhe forma e ushqimit. Kur ushqimi jepet në formë pelete përmirësohet tretja, dhe higjiena e ushqimit, si dhe pakësohen humbjet e tij. Madhësia e grimcave, ngjyra, aroma, ndikojnë gjithashtu në konsumin e ushqimit. Madhësia e grimcave ndryshon sipas moshës së zogjve, po kështu ndryshon dhe formula e tij.

Në moshën 0-10 ditë duhet të përdoret minipelet-Starter.

Në moshën 10-24ditë, diametri i peletës duhet të jetë 2-3.5 mm –Grower.

Në moshën 25-42 ditë diametri i peletës duhet të jetë 3.5 mm-Finisher.

Ndikimi i përdorimit të ushqimeve të peletuara është më i madh në zogjtë në rritje.

Këta të fundit karakterizohen nga një intensitet i lartë i rritjes dhe kanë një

TEKNIKA E RITJES DHE E MBARËSHTIMIT TË ZOGJVE BROJLER, DHE PËRDORIMI I RACIONIT USHQIMOR ME USHQIME TË PELETUARA

asimilim më të lartë të lëndëve ushqyese. Kështu zogjtë e ushqyer me ushqime të peletuara kanë shtesa më të larta në peshë dhe shpërblim më të mirë të ushqimit. Ushqimi i peletuar përmirëson tretjen në brojler dhe rrit higjenën e ushqimeve duke rritur peshën në therje të brojlerve në moshën 35 ditë, 1.9 kg dhe në 42 ditë 2.4 kg (peshë e gjallë), përmirëson uniformitetin e tufës, përmirëson shpërblimin e ushqimit me 1.9-2,1 kg ushqim për kg mish të prodhuar. Përdorimi racional i ushqimeve proteinike, sidomos duke pasur parasysh koston e lartë të tyre është mjaft i rëndësishëm në të ushqyerit e brojlerve. Proteinat janë të domosdoshme për rritjen, dhe duhen përdorur atëherë kur japin produktivitetin maksimal, e lidhur kjo me moshën e brojlerve. Sot, në të ushqyerit e brojlerve përdoren PROGRAMET LINARE për të gjetur kombinimet e përshtatshme të përbërësve në racionin ushqimor të zogjve të cilët kanë kosto të ulët. Meqenëse çmimet e përbërësve të racionit ndryshojnë, kombinimi më i mirë i përbërësve për një racion do të ndryshojë duke futur përbërës me kosto të ulët, për këtë arsye këto quhen " formulime me kosto të ulët të ushqimeve". Përdorimi racional i ushqimeve proteinike, sidomos duke pasur parasysh koston e lartë të tyre është mjaft i rëndësishëm në të ushqyerit e brojlerve. Proteinat janë të domosdoshme për rritjen, dhe duhen përdorur atëherë kur japin produktivitetin maksimal, e lidhur kjo me moshën e brojlerve.

Strukturë e racionit ushqimor në brojler

Grupet e ushqimeve	Faza e parë	Faza e dytë
Drithërat	56-60 %	60-65 %
Ushqimet proteinike bimore	30-35 %	20-25 %
Ushqimet proteinike	4-7 %	3-5 %
Ushqimet minerale	2-3 %	2-3 %
Premikse min-vitaminore	0,5-1,5 %	1-1,5 %
NaCl	0,2-0,3%	0,2-0,3 %
Yndyrë teknike	2-3 %	2-5 %

Ushqimet e peletuara, rëndësia dhe avantazhet e përdorimit të tyre

Peletimi është procesi i ndryshimit të teksturës së ushqimit me ndihmën e ngopjes me avuj uji apo kondicionimit dhe presimit deri në paraqitjen e tij në formë peletash ose granulash. Prosesi i përpunimit të ushqimit për të formuar peletën ose peletën e thëmuar kalon në 6 hapa të rëndësishme, formulimi i recepturës, bluarja dhe përzierja, kondicionimi, peletimi, tharja dhe ftohja, granulimi ose thërmimi i peletës. Pjesa më e madhe e dietave të brojlerve sot janë ushqime të peletuara ose formë e granuluar. Brojleret gjatë të ushqyerit shpenzojnë më

shumë kohë duke konsumuar dhe duke tretur se sa duke ngrënë peleta, kështu duke rezultuar me një energji të metabolizueshme të ulët si pasojë e të ushqyerit me ushqime të peletuara çon në uljen e sasisë së lëndëve ushqyese për njësi shtesë peshe. Prodhimi i ushqimeve për blegtorinë është një nga aktivitetet më kritike dhe strategjike në fushën e prodhimit blegtoral, për shkak të rritjes së vazhdueshme të kërkesës për produkte blegtorale nga sistemet intensive industriale të këtij sektori. Industria e prodhimit të ushqimeve për blegtorinë në botë filloi si një degë ndihmëse e tregtisë së drithërave dhe e industrisë së blajës, dhe sot ka evoluar në një industri komplekse, që ofron shërbime për rritësit dhe kultivuesit e kafshëve dhe shpendëve, si dhe për sektorin e akuakulturës. Këto peleta u përdorën për brojlerët. Aktualisht në vendin tonë janë fabrika të mëdha (AIBA Co, AGROTEK Co dhe Driza) etj, që prodhojnë ushqime për blegtorinë, dhe me atë kapacitet që kanë mund të mbulojnë të gjitha nevojat e këtij tregu. Duke realizuar kondicionimin e ushqimit u arrit që të përmirësohej tretshmëria e ushqimeve, cilësia e peletave, higjiena e ushqimeve. Industria e prodhimeve për blegtorinë është konsoliduar vazhdimisht, është rritur dhe automatizuar. Konsumi i ushqimeve për blegtorinë ka pësuar një rritje të dukshme. Fabrika dhe linja të ndryshme prodhimi punojnë me një teknologji të fundit. Agrotek sot prodhon ushqime të kombinuara që ruajnë parametrat e kërkuar cilësorë për llojet dhe kategoritë e ndryshme të kafshëve në tregun vendas. Teknologjia e zgjedhur është bashkohore. Kjo është e vetmja fabrikë në vend, e cila prodhon ushqime të peletuara. Kjo fabrikë prodhon ushqime cilësore, brenda standarteve europiane në formë peletash për llojet e ndryshme të blegtorisë. Ushqimet e peletuara tani përdoren gjërësisht në racionet ushqimore të shpendëve, derrave dhe kafshëve të tjera bujqësore në shumë vende të botës. Studime të shumta që janë bërë në vende të ndryshme të botës tregojnë efektet pozitive të ushqimeve të peletuara mbi treguesit e rritjes si edhe mbi tretshmërinë e racionit ushqimor në brojlerët, pulat e detit dhe shpendët e ujit. Përdorimi i peletave ka përmirësuar konvertimin e ushqimit në sajë të rritjes së tretshmërisë, duke reduktuar, dhe duke ulur energjinë e përdorur gjatë konsumit të ushqimit. Peletat me cilësi të lartë janë më të qëndrueshme ndaj myqeve në siloset e ruajtjes. Ushqimet e peletuara përdoren gjërësisht në industrinë e shpendëve. Nga provat e kryera ka rezultuar se ushq-

imet e peletuara kanë ndikuar në rritjen e peshës trupore shtesës së peshës dhe uniformitetit, si pasojë e asimilimit më të mirë nga ana e organizmit të shpendëve.

Avantazhet e përdorimit të ushqimeve të peletuara

Epërsia e ushqimit të peletuar në krahasim me atë pluhur lidhet me formën fizike të tij. Kështu mund të themi që peletat kanë një efekt më pozitiv në prodhimtarinë e kafshës në krahasim me ushqimin pluhur për arsye që do të përmendim më poshtë:

- Përmirësohet higjiena e ushqimeve. Kontaminimi nga salmonelat apo mikrobet e tjera (qofshin banale, apo patogjene) ulët ndjeshëm si rezultat i trajtimit termik të ushqimit gjatë procesit të peletimit.

- Minimizohen humbjet e ushqimit. Ushqimi i peletuar është 25% më i rëndë se sa ai i miellëzuar, për pasojë shpendët do të konsumojnë më pak ushqim në volum për të siguruar të njëjtën sasi lëndësh ushqyese.

- Çdo peletë është në vetvete një racion i balancuar, pra në këtë rast parandalohet përzgjedhja e përbërësve më të shijshëm të ushqimit.

- Si rezultat i minimizimit të humbjeve kërkohet më pak ushqim në total.

- Përmirësohet ngrënshmëria e ushqimit.

- Si rezultat i rritjes së densitetit kërkohen më pak hapësira magazinimi, dhe më pak hapësirë për front ushqimi.

- Ndonjë inhibitor i rritjes aksidentalisht prezent në ushqim shkatërrohet gjatë procesit të peletimit (myqet, kërpudhat), duke rritur garancinë cilësore.

- Gjatë procesit të ambalazhimit, apo transportit nga fabrika në fermë humbjet në formë pelete janë minimale. Gjithashtu ushqimi i peletuar është i thjeshtë e i përshtatshëm për sistemin e shpërndarjes së ushqimit në brendësi të lokalit.

- Bëhet me saktësi administrimi i medikamenteve në ushqime.

- Peletimi mund të përmirësojë tretshmërinë e ushqimit gjë që çon në një përmirësim të performancës në tufat e shpendëve.

- Përmirëson tretjen në brojler, dhe rrit higjenën e ushqimeve duke rritur peshën në therje të brojlerëve në moshën 35 ditë 1.9 kg dhe në 42 ditë 2.4 kg (peshë e gjallë).

- Përmirëson uniformitetin e tufës.

- Përmirëson shpërblimin e ushqimit me 1.9 -2,1 kg ushqim për kg mish të prodhuar.

- Shkurton kohën e majmërisë nga 49 ditë në 35-42 ditë, duke siguruar një ballancim të përshtatshëm ndërmjet elementëve të racionit komform fazave fiziologjike.

Por ky proces ka edhe dizavantazhe, të cilat mund ti përmbledhim si vijon:

- Rritja e koston së prodhimit.

- Shkatërrimi i mundshëm i disa vitaminave dhe mikroelementëve ushqimorë.

- Rritet konsumi i ujit tek kafshët, gjë që shoqërohet me shtimin e jashtëqitjeve, dhe për pasojë mund të ketë probleme me shtresën.

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale: QTTB- Fushë Krujë:
E-mail: qttbfushekrue@yahoo.com

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

Prodhimi i misrit në vitin 2021, ishte i kënaqshëm në shumicën e vendeve të rajonit. Në Shqipëri u prodhuan rreth 370 000 ton, me një rendiment rreth 6.7 ton/ha. Është ndër prodhimet më të larta të realizuara në 10 vitet e fundit. Megjithatë Shqipëria përsëri ka nevojë më të mëdha për këtë produkt. Importohen mbi 100 mijë ton në vit. Në verën e vitit 2021, në tregun e drithërave u vërejt një rritje e shpejtë e çmimeve. Në 2 muajt e fundit ato pothuajse u dyfishuan. Kjo tendencë u thellua më tej në kushtet e konfliktit Rusi - Ukrainë. Aktualisht çmimet e drithërave në tregjet me shumicë janë të nivelit 340-370 euro/ton. Akoma më problematik është fakti që vendet më të mëdha eksportuese kanë vendosur kufizime në eksportin e drithërave në ditët e fundit, dhe kjo nuk dihet sa do të zgjasë. Kjo ka sjelle jo vetëm mungesa të këtij produkti në treg, por edhe rritje të mëtejshme të çmimit. Nga ana tjetër, edhe kostoja e prodhimit të drithërave ka pësuar rritje. Dy elementë bazë të kostos (që përbëjnë rreth 70 % të shpenzimeve), punimet mekanike dhe plehrat kimike, në veçanti ato azotike, kanë pësuar rritje të papara në 20 vitet e fundit. Punimet mekanike për efekt të rritjes së çmimit të karburanteve me mbi 50 %, kurse plehrat kimike me 200-300 %.

Në këto kushte gjendemi para dilemave të mëdha. A kemi mundësi të rrisim sipërfaqen e kultivimit dhe prodhimin e misrit në Shqipëri? Unë mendoj se po. Dhe jo vetëm po, por është më se e nevojshme, pothuajse e detyrueshme rritja e prodhimit të drithërave, në veçanti e misrit ku rezervat janë më të mëdha. Kemi shumë sipërfaqe toke të lëna djerë, në zonë fushore, nën ujë, ose me mundësi ujitje me një minimum investimi. Të tilla janë rreth 50 000 ha. Shumicën e tyre në bashkitë Shkodër, Lezhë, Kurbin etj. (Mbahen në "inventar" si livadhe shumëvjeçare). Rritja e shpenzimeve, në punimet mekanike mund të kompensohet deri në një farë mase me skemat mbështetëse për karburante në bujqësi. Tashmë ato po aplikohen.

Përsa i takon plehrave kimike, prodhimi i drithërave është i pamundur pa përdorimin e tyre. Megjithëse me çmime të larta ato janë efikase. Në grupë apo misër çdo kg pleh kimik i përdorur në kushtet e teknologjive të përshtatshme të kultivimit shpërblehet me jo më pak se 6-8 kg drithë, grupë apo misër. Me çmimet aktuale të drithërave, dhe me prognozen se ato vështirë mund të ulen të paktën gjatë këtij viti, përdorimi i plehrave kimike është jo vetëm i domosdoshëm por edhe me interes në rritjen e të ardhurave të fermerit. Aktuale është sot për bimën e grurit, pasi fatmirësisht e kemi në faza

Problematikat e kultivimit të misrit në Shqipëri Zgjedhja e hibrideve të misrit për mbjelljet e pranverës 2022

zhvillimi të vonuara për efekt të një dimri me temperatura të ulëta. Hezitimi i përdorimit të plehrave azotike se ato janë me çmime të larta, sot është i gabuar. Është urgjente hedhja e dy-tre duarve, me distancë kohore ndërmjet tyre 12-15 ditë, përndryshe prodhimi do të jetë shumë i dobët dhe jo cilësor.

Teknologjitë e aplikuara nga shumica e fermerëve në kultivimin e misrit gjatë vitit 2021 kanë qenë efikase duke filluar nga zgjedhja e hibridit, përdorimin e një sasi të duhur të plehrave kimike, rritja e shkallës së mekanizimit të proceseve teknike të shërbimit ndaj bimës deri në vjelje.

Eksperiencia e fermerëve të bashkisë Sarandë në kultivimin e misrit, është zgjeruar edhe në bashki të tjera si Gjirokastrë, Elbasan, Lushnjë, Lezhe, Shkodër, Korçë etj. Kultivuesit me sipërfaqe relativisht të mëdha (50-150 Ha) e konsiderojnë këtë aktivitet si një "biznes" të mirëfilltë dhe fitim prurës. Janë rreth 12 000 ha ku rendimenti është stabilizuar në nivele 10-14 ton/ha misër kokërr. Me çmimet e tregut të vjeshtës së kaluar fitimi për një ha ka qenë 150-200 000 lekë/ha. Kostoja e prodhimit në këto nivele rendimentesh është 18-24 leke/kg. Luhatjet lidhen me tregun e qerasë së tokës, nivelin e mekanizimit dhe mënyra e realizimit të procesit të ujitjes.

Në kushtet e sotme, me aplikimin e skemës së mbështetjes të karburantit, mendojmë se kostoja e prodhimit të misrit tek fermerët e mëdhenj dhe të mesëm (me sipërfaqe misri 10-150 Ha), edhe me rritjen e çmimit 2-3 fish të plehrave kimike azotike, do të jetë në kufijtë 24-31 lekë/kg. Nëse respektohen e zbatohen teknologji të përshtatshme (për të realizuar 10-12 ton/ha), prodhimi i misrit mbetet fitimprurës. Ndoshta jo në nivelin e vitit të kaluar, por jo pak se 100-120 000 lekë/ha

Fermerët në Shqipëri, tashmë mbjellin mbi 90% të sipërfaqes së misrit me fara hibride. Pjesa më e madhe e saj importohet, kryesisht nga Shtetet e Komunitetit Evropian dhe atyre të rajonit. Dominojnë kryesisht fara hibride të ciklit të mesëm dhe të vonë (klasa FAO 500-700). Është e rëndësishme gjithashtu të theksojmë faktin se është rritur cilësia e kërkesës së fermerëve, kultivues të misrit për fara hibride me kapacitet prodhues e përshtatshme të lartë. Bazuar në eksperiencën e tyre, tashmë ata i diktojnë importuesve të farës të sjellin në treg, pikërisht farat që ato i njohin mirë. Në qarqe me sipërfaqe të madhe të kultivimit misrit si Shkodër,

